

kulturë



Rexhep Qosja

(25 qershor 1936 – 23 prill 2026)

Kolosi i kombit • Fenomeni i kulturës shqiptare • Karakteri emancipues i veprimtarisë krijuese të Rexhep Qosjes • Shqiptarët, gjithnjë të vonuar! • Arratisja nga vendi i kaosit etnik • Intelektuali që fliste në emër të popullit të plagosur • “Ky libër na ra nga qielli si një meteorit” • Rexhep Qosja në sytë e Shqipërisë së viteve 1968-1990 • Një figurë e shndërruar në simbol të identitetit modern nacional • Antologjitë e letërsisë shqipe të Rexhep Qosjes • Vdekja më vjen prej syve të tillë • “Një zbulim i vërtetë, ky shkrimtar është i madh”

IN MEMORIAM: REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

Kolosi i kombit

Rexhep Qosja (1936-2036), njeriu që shkaktonte bujë më shumë se kushdo tjetër anekënd botës shqiptare, e la amanet të përcillej pa u trumbetuar, thjesht dhe i shoqëruar vetëm nga familja e tij, sepse, tek e fundit, jeta është luftë, vdekja është paqe. Sa ishte i gjallë, kurrë nuk shkroi vetëm për Kosovën, por për gjithë kombin, ndërsa në udhëtimin e fundit vendosi të përcillej vetëm nga familja e tij. Kjo s'do të thotë që i dorëzoi armët. Përkundrazi, ky akt i fundit e ktheu atë vetë në armë për ardhmërinë e vendit

Ag Apolloni

Për Rexhep Qosjen kam folur e kam shkruar shpesh, edhe atëherë kur të shkruaje për të ishte njësoj sikur t'u dilje shigjetave përpara. Megjithatë, më vështirë e kam ta shkruaj këtë shkrim sot, për arsye se profesori nuk është më. E kam pasur profesor, mentor dhe mik. E, sigurisht, edhe shkrimtar të preferuar. Për dallim prej shumë profesorëve, ai nuk na jepte vetëm dije, por edhe guxim. Dhe, si çdo mësues i madh, mësimit nuk na e jepte vetëm nëpërmjet ligjëratave, por edhe nëpërmjet shembullit të vet. Fundja, nxënësit e mirë më shumë ndjekin modelet sesa mësimit.

Çfarë modeli na ofronte figura e tij? Modelin e njeriut që rezikon, modelin e njeriut që nuk nënshtrohet, modelin e njeriut që revoltet. Revoltë e pastër ishte edhe testamenti i tij, për të cilin isha në dijeni, sepse diçka më kishte treguar profesori, diçka nipi i tij. Nipi më pati thanë "gjyshi e ka shkru testamentin, ka me i befasu krejt", mirëpo paraprakisht profesori më kishte thënë se donte të largohej pa ceremoni shtetërore, se ishte i indinjuar me mënyrën si ishin sjellë ndaj tij dhe ndaj njerëzve të dijes, dhe prandaj as për së vdekuri nuk i duronte fjalimet hipokrite në varre dhe komemoracione (ata që ia kanë lexuar romanet, e dinë se si tallej ai me fjalimet mortore).

Megjithatë, edhe pse besojta se mua s'do të më befasonte aq sa të tjerët, prapëseprapë kur mëngjesin e 23 prillit mora një thirrje nga një mik që punon në televizionin shtetëror të Kosovës (atje duhej të ishte mesditë, këtu, në Boston, ishte ora gjashtë e mëngjesit) për të më pyetur nëse ishte e vërtetë ajo çka kishte postuar nipi i profesorit, meqë nuk mund ta jepte lajmin pa e verifikuar, u trondita dhe i thashë të më jepte dy minuta kohë, se as s'e dija ku isha, as çfarë kishte ndodhur. Pasi e pashë njoftimin, m'u kujtuan fjalët e të dyve, gjyshit dhe nipit, dhe ia konfirmova se njoftimi ishte i vërtetë. Në atë çast, e imagjinova fytyrën e qeshur të profesorit dhe, si dikush që ishte në dijeni të planit të fundit të tij, thashë me vete: Të lumtë! Ndërkohë, lava sytë, u kthjella, dhe m'u kujtua që ishte 23 prilli, Dita Botërore e Librit, datë kjo e vendosur para tri dekadash nga UNESCO, për nder të Shekspirin dhe Servantesit. Gjiganti i letërsisë shqipe iku për t'iu bashkuar gjigantëve të letërsisë botërore. Në 'kalendarin kombiar', Rexhep Qosja gjithmonë do të nderohet nga lexuesit shqiptarë në Ditën e Librit. Për një vdekje si kjo, më shumë se të mërzitesh, mund të ndihesh xheloz. Ishte një fund me fat. S'ka thënë kot Virgjili: fati i do guximtarët.

Kultura e Kosovës

Në vitet '50, kur Rexhep Qosja erdhi nga fshati Vuthaj (Malësi, Mal i Zi), Prishtina ishte shkret, sidomos fushat e arsimit dhe kulturës. Nëse kishte ndonjë shenjë të jetës letrare e kulturore, ajo i detyrohej bashkëvendësit të tij, Esad Mekulit, puna entuziaste e të cilit e themeloi letërsinë e Kosovës, ku shkëlqeu Rexhep Qosja, i cili e ka thënë edhe në ditarin e tij se pa shtyrsën e Mekulit, nuk do të shkruhej, as botohej, romani i tij i parë.

Me kalimin e viteve, Rexhep Qosja u bë një student i dalluar i letërsisë dhe doktori i parë nga kjo fushë. Ai u bë figurë e dalluar në institucionet kryesore shkencore dhe arsimore të Kosovës: drejtor në Institutin e Albanologjisë, profesor në Universitetin e Prishtinës dhe anëtar në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Në letërsi, shpërtheu në vitet '70: ishte kryeredaktor i revistës letrare Jeta e Re, shkroi dramën "Sfinga e gjallë", "Beselam, pse më flijojnë" dhe "Vdekja e një mbretëreshë", romanin "Vdekja më vjen prej syve të tillë", që mbetet roman unik në letërsinë



Fundi i tij s'duhet parë si shenjë modestie, por si revoltë e fundit. Ai i bëri një refuzim filozofik politikës që nuk ia di vlerën kulturës. Testamenti është shkruar më 2016, mirëpo pozita e intelektualëve, shkrimtarëve, artistëve, filozofëve, profesorëve, shkencëtarëve, nuk ka ndryshuar fare. Ai luftoi gjithë jetën për kulturën e kombit të tij

shqipe të shekullit XX, kurse vitet '80 i filloi ashpër me librin polemik "Morfologjia e një fushate" për të dominuar si kritik letrar përgjatë gjithë dekadës; në vitet '90 boton vetëm libra publicistikë e dokumentarë, për t'iu kthyer prozës vetëm pas çlirimit ("I ringjalluri i penduar", "Një dashuri dhe shtatë faje", "Nata është dita jonë", "Bijtë e askujt" dhe "Të fshehat e treguara"). Me një krijimtari prej rreth 50 veprash, Qosja ka dominuar mbi 50 vjet në jetën kulturore të Kosovës, duke u bërë një figurë me ndikim të madh, aq sa në vitet '90 delegacionet ndërkombëtare shpesh së pari shkonin në zyrën e tij, pastaj në zyrat e partisë që udhëhiqte politikën e Kosovës, meqë ai ishte bërë shkrimtar dhe intelektual më i njohur i këtij vendi, duke u botuar nga dy botues të mëdhenj francezë, Fayrad ("La question albanaise") dhe Gallimard ("La mort me vient de ces yeux-là").

Edhe zhvillimi i teatrit dhe kinematografisë lidhet me veprat e tij. Dramat e tij, si tekste dhe shfaqje, kanë qarkulluar dhe janë shpërbyer edhe jashtë vendit, ndërsa filmi "Rojet e mjegullës", i bazuar mbi romanin e tij të parë, mbetet si filmi kosovar më i mirë i shekullit të kaluar.

Pra, një personalitet kaq i madh, që lidhet me Institutin, Universitetin, Akademinë, revistën kryesore letrare, si dhe me teatrin dhe filmin, apo edhe me politikën, s'ka si të mos kujtohet dhe vlerësohet si një nga shtyllat mbi të cilat mbahet kultura kosovare dhe ajo shqiptare, në përgjithësi. Ai nuk ishte thjesht një nga fytyrat e këtyre institucioneve, por ishte dhe mbetet identiteti i tyre; ato njihen për shkak të tij: Institutin ishte shtëpia e tij e dytë, Universiteti i Prishtinës s'ka pasur një person më të njohur se ai në historinë e vet, Akademia njihet si vend i akademikut. Më duket e çuditshme, por është e vërtetë, që Kosova ka pasur dy persona që janë njohur bashkë me titujt e tyre: Akademik Rexhep Qosja dhe Dr. Ibrahim Rugova. Për ne që marrim vesh në këto punë, e dimë që Qosja ishte gjithashtu

doktor dhe Rugova gjithashtu akademik (korrespondent), mirëpo në sytë e të tjerëve, ata mbetën me tituj të ndryshëm. Dhe bënë mirë që mbetën përgjithmonë ashtu, sepse përdërisa studimi i letërsisë i bashkonte, vizioni politik i ndante.

Ai përballë të gjithëve

Qosja ka polemizuar me të huajt dhe me shqiptarët. Kur them me të huajt, kuptohet menjëherë që në rastin e Qosjes këto ishin polemika me serbët dhe maqedonasit. Janë sidomos vitet '80 kur pena e tij u kthye në shpatë për t'i mbrojtur shqiptarët, identiteti dhe ekzistenca e të cilëve rrezikohej nga fqinjët. Janë pikërisht këto polemika të ashpër që i krijuan atij aurën e një mbrojtësi të kombit. Prandaj edhe nisën ta thërrasin Baba i Kombit. Guximi i tij intelektual mobilizoi masat që sollën 'erë ndryshimi' në Kosovë. Ato tekste janë shembull i mbrojtjes intelektuale të një kombi. Në polemikat me fqinjët, ishte ai përballë atyre, një kundër të gjithëve, diçka si Davidi kundër Goliatit. Dhe në fund, natyrisht, fitoi Davidi ynë.

Krahas polemikës me të huajt, ai polemizonte edhe me shqiptarët, fillimisht për arsye gjuhësore, letrare e kulturore, më vonë edhe për arsye politike. Për arsyet e para, i kritikoi që kur nisi të publikojë, ndërsa për arsyet e fundit i kundërshtoi dhe luftoi nga vitet '90. Nuk ishte përballje mes Akademikut dhe Doktorit, por përballje e Akademikut me një mekanizëm mediatic që sa vinte e rritej, duke filluar me të përditshmen (në fakt, me të gërditshmen) "Bota Sot" e deri te gazetatat dhe portalet e shumta në Kosovë dhe Shqipëri. Pra, prapë ishte Ai dhe Ata. I vetëm përballë të gjithëve. E thënë me fraza të sotme, pamundësia e mediave për ta mposhtur është 'storje sukses' për të dhe për ne; është shembull frymëzimi.

Për shkak të demonizimit që i bënte mediat, një aparatçik pacifist, kur u emërua drejtor i Institutit, gjërat e para që bëri, ishin këto: e theu derën e zyrës

së Qosjes, ia hodhi dorëshkrimet dhe librat në thasë plehrash dhe e largoi dhunshëm nga Institutin. Besoj që shumicës i kujtohet kjo ngjarje kur profesori ulej para Institutit, sepse s'e lirin të hynte brenda. Pasi vërshuan reagimet nga Kosova dhe Shqipëria, ndërhyri Qeveria dhe e zgjidhi problemin, duke e larguar "drejtorin" dhe duke e futur brenda profesorin. Dhe kjo ndodhi disa vjet pas luftës.

Siç e ka shkruar edhe në ditar, për shkak të qëndrimeve të tij i ka provuar të gjitha: atentatin, sulmet fizike dhe verbale, kërcënimet, por asnjëherë nuk është ndaluar. Disa kanë shkruar edhe libra kundër tij, por s'ua ka lexuar askush. Ai me një fjali kundër tyre, i ka bërë qesharakë, aq sa disa kurrë më s'janë marrë seriozisht as në letërsi, as në politikë. Kishte mësuar diçka nga Volteri, dhe jo rastësisht një kritik francez e quan Volter i Ballkanit. Ajo thënia që i atribuohet iluministit francez, i shkoi edhe Qosjes: "U luta: O Zot, bëji armiq të mi qesharakë! Dhe Zoti më dëgjoi".

Për shkak të polemikave, reagimeve dhe komenteve politike, edhe pse Rexhep Qosjes direkt s'kanë arritur t'i bëjnë asgjë, i janë hakmarrë te të afërmit e tij, duke ia larguar nga puna. Dhe kjo hakmarrje e ulët sigurisht e ka prekur. Ai nuk i përtonte duellit, veçse e dëshpëronte ulja e nivelit.

Do të ishte mirë për të gjithë që mekanizmat mediaticë tash e tutje të mos i sulmonin intelektualët, por nëse ata vazhdojnë të njëjtin avaz, intelektualët kanë shembullin që mund ta ndjekin. Fundja, letërsia është gjithmonë më e fuqishme se gazetaria, si nga mendja, ashtu edhe nga zemra.

Në polemikë, Qosja ishte Konica i kohës sonë. Nuk numërohen kundërshtarët e Konicës, as të Qosjes. Por të gjithë ata i kujtojmë vetëm si numra, kurse këta kanë mbetur emra.

Fama, shteti dhe kombi

Rexhep Qosja u përkthye në disa qubhë para viteve '90, mirëpo vetëm pas interesimit të botuesve të mëd-

henj francezë, i trokiti fat në derë. Ai mund të ulej dhe të shkruante romane tashmë që kishte gjetur botues evropianë, por nuk e bëri. Në vend se t'ia hapte derën fatit të tij, u çua për t'ia mbyllur derën fatkeqësisë së kombit të tij. Në vend të romaneve, shkroi publicistikë. Në njëfarë mënyrë, e flajoi famën e garantuar ndërkombëtare për çështjen kombëtare. Nuk shqetësohej, sepse, fundja, letërsia s'është gazetari. Nuk vjetrohet brenda dite. Kurdo që të përketen romanet e tij të shkruara pas luftës, sidomos "Një dashuri dhe shtatë faje" dhe "Nata është dita jonë", do të gjejnë lexues nëpër botë.

Rexhep Qosja mbeti figurë kombëtare, ndryshe nga Ismail Kadare që u bë figurë ndërkombëtare. Ishte zgjedhje e tyre, jetonin në rrethana të ndryshme. As Ibrahim Rugova nuk u bë figurë ndërkombëtare. Le t'i quajmë zgjedhje të vetëdijshme të tyre. Rugova mbeti figurë shtetërore, Qosja – figurë kombëtare. Pra, janë modelet të ndryshme dhe është gabim t'i krahasojmë. Projekti për të cilin punoi Rugova, u finalizua nga Thaçi. Projekti për të cilin punoi Qosja, mund të realizohet një ditë, por nuk e dimë se kur dhe nga kush. Ngjashëm me një titull të Habermasit, projekti madhor për të cilin Qosja punoi gjithë jetën mund të quhet "Bashkimi Kombëtar, projekt i pakryer".

Pra, Rugova mbetet i figurë e rëndësishme shtetërore, edhe pse ëndërrën e tij e realizoi rivali i tij politik më 17 shkurt 2008. Qosja mbetet figura më e rëndësishme kombëtare bashkëkohore, si Kolosi i Rodosit, sepse kombi e vuri para çdo gjëje dhe shkroi projektin për bashkim, e s'ka rëndësi se kush do ta realizojë. Ndërsa, Kadare është figura më e madhe ndërkombëtare që kemi pasur ndonjëherë. Shteti, kombi dhe ndërkombëtarizimi kanë emrat e tyre, dhe janë projekte dhe identitete të dobishme dhe të ndryshme.

Një polemikë e heshtur mund të quhet puna e dy kosovarëve, Doktorit dhe Akademikut, paksa si Haveli me

Kunderën. Ndërsa polemika e famshme Kadare-Qosja, tregon se i pari ishte idealist (do të ishte ideale, sipas tij, që shqiptarët të ishin të krishterë, sepse Evropa, edhe kur deklarohet si sekulare, krishterimin e ka pjesë të kulturës), kurse i dyti ishte realist (nënteksti i polemikës së tij thotë se ndoshta është mirë të jemi të krishterë, por s'jemi, dhe duhet të pajtohemi me fatin). Kadare flet si shkrimtar që mund të konstruktojë realitete, Qosja si shkencëtar që duhet ta pranojë realitetin. Në dëshira janë të njëjtë, sigurisht, por në argumente janë të ndryshëm.

Përplasja e tyre ka qenë më e bujshme në historinë tonë, mirëpo, pavarësisht përshtypjes që kanë lënë tek lexuesit, ata kanë qenë miqtë më të mirë. Këtë e di mirë, sepse disa herë në takimet me ta, i kam pyetur për njëri-tjetrin. Për humor, Qosja preferonte Agollin, Kadare Shkrelin, por për të diskutuar çështjet më të ndjeshme ata dy zgjidhnin njëri-tjetrin. Kjo ngjan pak a shumë si historia e dy Ivanëve të Gogolit, dhe shkrimtarëve u kanë hije sjelljet e tilla.

Për shkak të kësaj 'skizme' të madhe, kur mbrojtja masterin për prozën e Qosjes, më etiketonin si 'adhurues i Qosjes' dhe 'armik i Kadaresë'. Pastaj, kur mbrojtja doktoratën për Kadarenë, kujtonin se i kam prishur punët me Qosjen. Dikur u dorëzuan, sepse s'e kuptonin me kë isha, dhe s'ua merrte mendja se mund t'i vlerësoja të dy. Viteve të fundit çuditën pse s'flas kundër Rugovës, madje kur kam kohë, them edhe fjalë të mira për të. S'mund të jesh edhe me Rugovën, edhe me Qosjen, edhe me Kadarenë, thonë. Pse jo?, them. Me raste, mund ta kenë kundërshtuar njëri-tjetrin, por të tre i kanë dashur, si idealistë të papërmirësueshëm, shtetin, kombin dhe gjuhën. Në një intervistë të viteve '90, nga letërsia e Kosovës, Rugova e veçonte romanin "Vdekja më vjen prej syve të tillë". Po në vitet '90, Kadare shkroi parathënien për botimin frëngjisht të këtij romani, duke e konsideruar Qosjen si Kafka i Kosovës.

Qosja në polemikën me Kadarenë ishte realist, por në politikë ishte idealist. Ai nuk mund ta kuptonte sesi komunistët ktheheshin brenda nate në demokratë, sesi shërbëtorët e regjimit të djeshëm ishin kthyer në udhëheqës të sotëm të vendit, i cili ishte ndarë me luftë nga ai regjim. Ai nuk e kuptonte se si tradhtari bëhej atdhetar, se si analfabeti bëhej akademik, se si ateisti predikonte fenë, se si viktimia e puthte xhelatin, se si frikacak u shite trimëri, se si çlirimtari s'kishte liri, se si i korruptuari luftonte korrupsionin, se si hajnia çmohej si zotësi. Shumë gjëra të tilla s'i kuptonte Rexhep Qosja dhe pikërisht për këtë "paafësi", e çmoja. Po të parafrazojmë një thënie të njohur, mund të themi se politika ishte një ballo me maska ku Rexhep Qosja kishte shkuar me fytyrën e vërtetë. Ai besonte se politika ishte për të na e rregulluar jetën, jo për të na e bërë lëmsh. S'e dinte që politika, në shumicën e rasteve, është për t'u dhënë rrogë atyre që s'vlejnë as për rrogëtarë. Nuk e dinte, apo nuk donte ta besonte, që në politikë më e rëndësishme është dredhia sesa dija. Në një shoqëri si e jona s'është e lehtë të pranohet një logjikë si e tij.

Për fund, fundi i tij s'duhet parë si shenjë modestie, por si revoltë e fundit. Ai i bëri një refuzim filozofik politikës që nuk ia di vlerën kulturës. Testamenti është shkruar më 2016, mirëpo pozita e intelektualëve, shkrimtarëve, artistëve, filozofëve, profesorëve, shkencëtarëve, nuk ka ndryshuar fare. Ai luftoi gjithë jetën për kulturën e kombit të tij. Me aktin e fundit të realizuar sipas testamentit të tij, Rexhep Qosja nuk i dorëzoi armët, por u kthye vetë në armë për ardhmërinë e artit dhe kulturës në vendin e tij. Ndryshe nga romanet tradicionale që në fund i mbyll dhe s'i prek më, tipi i romanit që shkruante ai, fillon të marrë kuptim pasi mbaron, prandaj një nga shkrimtarët dhe teoricienët e tij të preferuar e quante 'vepra e hapur'. Njësoj mund të thuhet për jetën e tij. Jeta e pavdekshme e Rexhep Qosjes fillon tash pas mbylljes, si një 'jetë e hapur', me mesazhe të fuqishme. Largimi i tij ashtu ishte një befasi e madhe, mirëpo qëllimi i një largimi të tillë ishte që të linte një Porosi të Madhe.

© KOHA Ditore

Rexhep Qosja – fenomen i kulturës shqiptare

Akademik Rexhep Qosja, jo vetëm me veprën e tij shumëplanëshe shkrimore, por edhe me qëndrimin parimor intelektual, në kohë të vështira e dramatike të historisë, në rrafshin e determinimit të individit me kapacitete të jashtëzakonshme kreative e profesionale, përbën po ashtu një fenomen për mendimin shqiptar. Ky korpus shkrimor dhe e gjithë veprimtaria intelektuale e profesionale e kanë shndërruar autorin dhe kreatorin e tyre në një institucion të rëndësishëm kombëtar

Hysen Matoshi

"Edhe njerëzit e mirë duhet të vdesin, por vdekja nuk mund t'i vrasë emrat e tyre". Në këto ditë dhembjeje e pikëllimi, kur vdekja fizikisht e mori prej nesh profesorin, dijetarin, albanologun, filozofin, ideologun, romancierin, dramaturgun, kritikun letrar, historianin, publicistin, ditaristin, eselistin, polemistin, intelektualin jokonformist, veprimtarin e çështjes kombëtare, mbi të gjitha njeriun e një soji të veçantë, akademikun Rexhep Qosja, më duket tejet domethënës parafraximi i kësaj sentence daneze. Kjo vetëdije e bën relative vdekjen dhe gjithësesi më lehtë të përballueshme. Ka vdekur autori, por jo vepra e tij, jo trashëgimia e tij shumëplanëshe që përbën njërin ndër thesaret tanë më të çmuar kombëtarë. Ajo na përket të gjithëve, ajo, në mënyrë të veçantë, u përket brezave të pafundmë të shqiptarëve si një shenjë orientuese e shtegimit më të sigurt në ardhmëri.

Janë më se 50 vepra shkrimore dhe më se 20 mijë faqe të shkruara e të botuara, madje një pjesë e konsiderueshme e tyre edhe të përkthyer në gjuhë të tjera, që e bëjnë Akademik Rexhep Qosjen një autor të patëdytë në historinë dhe në kulturën shqiptare. Megjithatë, kjo shtirje imponante vëllimorë nuk është esenca e punës ngulmuese e të vazhdueshme tërëjetësore, nuk është ajo që e shquan si njërin ndër personalitetet më të dalluara në kulturën dhe në historinë e përgjithshme shqiptare. Në rend të parë, karakterizuese janë vlerat e tij të verifikueshme shkencore, idetë dhe pikëpamjet e tij që, në të shumtën, janë dëshmuar si paravajtëse sa u përket zhvillimeve historike nëpër të cilat kaluan shqiptarët, pastaj është krijimtaria letrare, me nuancimet e saja tematike, kompozicionale e stilistike, e vlerësuar gjithandë për risimtarinë si shprehje e unitetit ndërmjet fiksonit dhe erudicionit, ndërmjet imagjinatës dhe dijës. Veprat e këtylla, origjinale dhe të papërsëritshme, si manifestim i vetëdijes së lirë autoriale, unike si krijimtari e gjithmbarshme, që kanë një lidhshmëri organike përmbytësore e strukturore, si vlera të kreativitetit shpirtëror e të racionalitetit mendor, e përbëjnë një fenomen kulturor.

Akademik Rexhep Qosja, jo vetëm me veprën e tij shumëplanëshe shkrimore, por edhe me qëndrimin parimor intelektual, në kohë të vështira e dramatike të historisë, në rrafshin e determinimit të individit me kapacitete të jashtëzakonshme kreative e profesionale, përbën po ashtu një fenomen për mendimin shqiptar. Ky korpus shkrimor dhe e gjithë veprimtaria intelektuale e profesionale e kanë shndërruar autorin dhe kreatorin e tyre në një institucion të rëndësishëm kombëtar.

Njëra ndër shenjat e originalitetit të Rexhep Qosjes shtrihet në letërsinë që krijoi ai. Prozat dhe dramet e tij përbëjnë një kthesë të guximshme dhe të ndjeshme kundruall traditës sonë letrare, ndërsa krijimtarinë e tij letrare nuk e bën të identifikueshme tematika e saj në përmasën që e bën vetë mënyra se si është shkruar ajo, përkatësisht të tillë e bën koherenca e padiskutueshme stilistike, që mban vullën e një universi të pashëmbyllyeshëm krijues në kontekstin shqiptar. Përveçse nuk ndjek, në mënyrë të veçantë, ndonjë model nga proza para-rendëse shqipe, lirish mund të thuhet se vepra e tij letrare mbetet në masë të madhe e paimitueshme, e paasimilueshme nga autorë të tjerë, rrjedhimisht deri sot pa trashëgimtarë të mirëfilltë.

Një fushë tjetër me rëndësi e veprimtarisë intelektuale e profesionale të Rexhep Qosjes ka të bëjë me studimet tona letrare. Për punën e tij shkencore janë thënë fjalë të mëdha. Puna dhe rezultatet e tij janë kraha-



Janë më se 50 vepra shkrimore dhe më se 20 mijë faqe të shkruara e të botuara, madje një pjesë e konsiderueshme e tyre edhe të përkthyer në gjuhë të tjera, që e bëjnë Akademik Rexhep Qosjen një autor të patëdytë në historinë dhe në kulturën shqiptare

suar me rezultatet e institucioneve albanologjike. Pa u ndalur në përmendjen e të gjitha veprave që e trajtojnë letërsinë shqipe, konsideroj se sintezat e mëdha studimore, sikurse janë historia trevëllimëshe e romantizmit shqiptar, monografite "Porosia e madhe, Asdreni – jeta dhe vepra", pastaj veprat "Prej tipologjisë deri të perioidizimit" dhe "Tri mënyra të shkrimit shqip" janë kontribute monumentale dhënë studimit të letërsisë shqipe. Përveçse ka shtruar, nëpërmjet tyre, çështje të rëndësishme për letërsinë shqipe dhe, në të shumtën, ka ofruar përgjigje të qëndrueshme e të argumentuara shkencërisht, lirish mund të pohohet se akademik Rexhep Qosja, me veprën e tij të gjithmbarshme studimore, është shndërruar në një shkollë studimesh albanologjike. Në rast se do t'i ndiqte modelet ekzistuese të studimit të letërsisë shqipe, që mbështeteshin në doktrinën e realizmit socialist, sot vështirë se do të mbahej mend, qoftë si historian, qoftë si kritik letrar. Duke ndjekur rrugën e bërjes së rrugës së re, ai që herët ka nxjerrë përfundime në të cilat shumë bashkëkohës të tij do të vinin vetëm dekada më vonë.

Jokonformizmi nuk nënkupton vetëm qëndrimin apriori kundër, nga një gjë e tillë çon në rrezikun e kundërvënies skematike. I vetëdijshëm për këtë, gjatë dekadave të punës së tij intelektuale, Akademik Rexhep Qosja e ka kultivuar vetëdijen kritike si vlerë që i shquan kombet e qyte-tëruara. Nuk ka reshtur asnjëherë t'i shprehë mendimet dhe vlerësimet mbi aktualitetin, mbi historinë, t'i mbrojtë qëndrimet e tij dhe të polemizojë për to. E ka bërë këtë në kontekstin shqiptar, por edhe në kontekste më të gjera ku janë diskutuar e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja e kombit të tij. Në shumicën

dërrmuese të shkrimeve publicistike ka angazhuar tërë qenien intelektual e morale në mbrojtje të çështjes shqiptare, duke publikuar monografi, analiza, kome-nte, reagime, intervista etj. Në këtë pikëpamje liria përbente esencën unifikuese të mendimit dhe të veprimit të tij, kryesisht të konceptuar si angazhim për jetësimin e lirisë së munguar të kombit shqiptar dhe të lirisë së mendimit si kusht për të krijuar një shoqëri humane dhe të përparuar gjithnjë mbi vlerat e njohura të demokracisë.

Kultura jonë – e përfaqësuar në një format unik shkrimi të njëjës ndër figurat më emblematike të botës bashkëkohore shqiptare dhe e definuar si fenomen risimtar – ka gjetur në veprën dhe veprimtarinë e Rexhep Qosjes një shenjë të qartë të identitetit tonë kulturor, një autor që e ka transformuar trënjësisht vetëdijen tradicionale, anakronike, mitike, folklorizuese, glorifikuese, himnizuese, epigonike, ideologjizuese, akademizuese drejt një vetëdije kritike e moderne si treguese e pjekurisë mendimorë dhe kulturore shqiptare. Vepra shkrimore e Rexhep Qosjes është një trashëgimi monumentale që e shndërron autorin e saj në një dukuri specifike dhe orientuese për rrjedhat e zhvillimit të dijes, të kulturës dhe të mendimit shqiptar.

Akademik Rexhep Qosja, si fenomen i papërsëritshëm kulturor e shoqëror, u takon njësoj të tri kohëve: të kaluarës si historian, e sidomos si historian i letërsisë, si autor që veprën e tij shkencore e bazon në faktografi e në argumente e gjithnjë duke i shpalosur, interpretuar dhe konstatuar aspektet më të dallueshme historike të identitetit shqiptar; ndërkohë që i takon bashkëkohësisis si krijues aktiv i vlerave të rëndësishme kulturore e diturore, por edhe si dëshmitar, si kritik dhe si vëzhgues objektiv i fenomeneve e zhvillimeve në jetën tonë

shoqërore, politike, kulturore, shkencore etj. dhe gjithësesi me trashëgiminë e tij shkrimore do t'i takojë edhe të ardhmës si vizionar, si ideolog, në krye të herës, i përqendruar tek e nesërmja e shqiptarëve, të përbashkësia funksionale e kombit, së cilës ia përkushtoi tërë jetën e tij.

Vdekja e Akademik Rexhep Qosjes është një humbje e pakompensueshme dhe shumëplanëshe: familja mbetet pa anëtarin e saj të dashur; Instituti Albanologjik pa vlerën identitare e më emblematike të tij, albanologjia pa themelvënesin e studimeve moderne shqiptare, jeta jonë shoqërore pa njërin ndër trajtat më të shprehura të mendimit objektiv e kritik të artikuluar në kohën dhe në mënyrën e duhur, shqiptarët kudo ndodhen, e veçmas ata të Kosovës Lindore dhe të Malit të Zi, mbeten pa zëdhënesin e përherëshëm e të patundur të të drejtave të tyre legjitime të mishëruara në idenë e bashkimit kombëtar, ndërsa e ardhmja e shqiptarëve në Ballkan mbetet pa mendjen më vizionare të kombit tonë. Megjithatë, nëse do ta kërkojmë, Profesorin do ta gjejmë në atë që është e pavdekshme dhe e patretshme, në veprat e tij, e gjithashtu edhe në kujtimet e paharrueshme e mbresëlënëse nga takimet dhe bisedat me të.

Këtë fjalë do ta përfundoj duke cituar një fjalë të vetme nga "Ditari" i tij: "Se kush ishte njeriu gjatë jetës më së qarti shihet ditën e vdekjes së tij". Në ditën e vdekjes së tij, ndër shqiptarët gjithandë pamë shumë dhembje dhe lexuam shumë vlerësime për Profesorin. Mbase më shumë se sa për të janë thënë gjatë gjithë jetës së tij. Ky fakt nuk e bën krenar vetëm Institutin Albanologjik, ky fakt e nderon kulturën dhe historinë shqiptare.

Qoftë i përgjeshëm kujtimi për Akademik Rexhep Qosjen, qoftë e paharrueshme vepra e tij!

© KOHA Ditore

IN MEMORIAM: REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

Karakteri emancipues i veprimtarisë krijuese të Rexhep Qosjes

Vepra jetësore e Rexhep Qosjes dëshmon për një dinamikë komunikimi të vetëdijes shkencore me vetëdijen politike kombëtare të tij. Vetëdija e studiuesit të letërsisë, qysh në gjysmën e dytë të viteve '60, do të jetë përgjigjja prospektive e vetëdijes politike të intelektualit të angazhuar për fatet e kombit të vet në mesin e viteve '80 e deri më sot

Arben Hoxha

Hyrje

Puna intelektuale e krijuese-artistike e akademik Rexhep Qosjes është e shumanshme dhe shtrihet në fusha të ndryshme të dijes e të aktivitetit shpirtëror: si eseist, si historian i letërsisë, si kritik letrar, si prozator, si dramaturg, si publicist, si polemist e të tjera. Pohimi i shqiptuar më lart nuk përbën as rëndësinë e një informacioni, e aq më pak – parë në vetvete – përbën ndonjë vlerë njohëse shkencore në lidhje me kontributin e veprimtarisë shkencore e letrare të Rexhep Qosjes në kulturën shqiptare. Numërimi i profileve të ndryshme krijuese të prof. Rexhep Qosjes është çështje faktesh empirike. Ajo që përbën vlerë kuptimore për interesin tonë njohës është çështja se si të arrihet te kuptimi i vlerës së këtyre fakteve në tërësinë dhe njëjtësinë brenda funksionit të tyre emancipues për kulturën letrare shqiptare, në veçanti, dhe të qenies shqiptare, në përgjithësi.

Për një trajtim qenësor të veprimtarisë së shumanshme të prof. Rexhep Qosjes konsiderojmë se vëmendja e studiuesit duhet të drejtohet në këto çështje:

- Çfarë është ajo që e përcakton unitetin në diversitete profilesh krijuese e intelektuale të Rexhep Qosjes?
- Cila është baza që e përcakton unitetin brenda diversitetit të profileve krijuese e intelektuale të Rexhep Qosjes?
- Cilat janë efektet e veprimtarisë shpirtërore dhe intelektuale të Rexhep Qosjes në strukturën e të menduarit të njeriut tonë në kushtet e kolonializmit jugosllav dhe të diktaturës komuniste në Shqipëri?

Të gjitha këto problematika ngrihen si pasojë e nevojës për identifikimin e karakterit emancipues të veprës tërësore të Rexhep Qosjes.

Baza e karakterit emancipues të krijimtarisë së Rexhep Qosjes?

Përcaktimi i bazës së karakterit emancipues të krijimtarisë së Rexhep Qosjes, paraprakisht, imponon nevojën për përkufizimin e konceptit të *emancipimit*, i cili në periudha dhe nga autoritete të ndryshme të dijes është konceptuar në mënyra të ndryshme. Emancipimi si koncept përmban dy aspekte: a) në njërin anë, ai përfaqëson aktin e shkëputjes “nga diçka” që e pengon zhvillimin e qenies njerëzore, “nga diçka” që është kufizuese, si: tradicionalizmi, ideologjia, morali i caktuar etj.; dhe b) përfaqëson aspektin e *kuptimit* të asaj që është penguese për gjenerimin e energjive krijuese njerëzore. Në rastin e parë, emancipimi shihet në raport me masën e ndryshimit të fakteve empirike; në rastin e dytë, emancipimi shihet në raport me zhvillimin e fuqive të të kuptuarit. Në teorinë e vet të njohjes, Jürgen Habermasi – emancipimin e shpreh si rezultat të lidhjes së pandarë që ekziston midis *fakteve* dhe *kuptimit*. Emancipimi pa dimensionin e kuptimit, i parë vetëm në kufijtë e dimensionit të fakteve empirike, është tejet i reduktuar, sepse në atë mënyrë ai zhvishet nga karakteri i tij transcendental. Ndërrimi i fakteve empirike e sjell emancipimin “nga diçka” paraprake. Ky lloj i emancipimit ndërlidhet me përmasën e aktualitetit të qenies (politike, sociale, kulturore, ekonomike, religjioze etj.). Ndërkaq, emancipimi përmes të kuptuarit, e fut në veprim edhe përmasën e potencialitetit të qenies njerëzore. Emancipimi “nga diçka” është reflektiv, që kushtëzohet nga faktorët e jashtëm; emancipimi me përmasën e të kuptuarit gjithnjë është reflektiv, që vjen nga brenda dhe çon në një vetëdije të transformuar. Emancipimi nga



Forcat aktive të vullnetit në punën krijuese e intelektuale të prof. Rexhep Qosjes do të jenë motori që do ta vënë në lëvizje mendimin e tij në frontin e bërjes dhe vetëbërjes së Vetes sonë komb me vetëdije moderne kulturore

një dogmë politike mund të burojë nga një arsye e re dogmatike, e cila i sjell një robërim të ri mendjes, ndërsa emancipimi që arrihet përmes arsyes kritike në mënyrë analitike e arrin fuqinë mbi paragjykimin dogmatik.

Në teorinë kritike të Habermasit, vetëreflektimi – përmes të cilit prodhohet kuptimi – përbën kategorinë the melore dhe rrugën e vetme të ndershme për emancipimin e njeriut. Vetëreflektimi, si njohje e gjendjes së unit, përmes vlerësimit, gjithnjë është në një proces negocimi e verifikimi të vetëdijes me mundësitë e unit. Vetëreflektimi – për Habermasin – sjell në vetëdije determinantë të një procesi vetëformues, të kultivimit dhe formimit shpirtëror, që ideologjikisht e përcaktojnë një praktikë bashkëkohore të veprimit dhe konceptimit të botës. Vetëreflektimi është një fuqi e gjallë vepruese, sepse ai nuk e bën ndarjen e fakteve nga vlerat. Për këtë arsye Habermasi – në teorinë e tij të njohjes – është kundër pohimit pozitivist që e barazon dijen pa vlera me faktet shkencore.

Nevojat ekzistenciale

Pyetjes sonë se çfarë e përcakton bazën emancipuese të krijimtarisë së Rexhep Qosjes, pas saktësisimit të për-

mbajtjes së konceptit të emancipimit, mund t'i përgjigjemi se karakterin emancipues të krijimtarisë së Rexhep Qosjes e përcakton aftësia e arsyes emancipuese të tij për reflektim metahermeneutikë, e kjo do të thotë aftësia e arsyes për të identifikuar, kuptuar dhe afirmuar jo vetëm nevojat njohëse që burojnë nga dimensionin e aktualitetit, por në mënyrë të veçantë të atyre nevojave që gëlojnë në dimensionin e potencialitetit të qenies sonë kombëtare e njerëzore.

Njohja e nevojave të karakterit transcendental, si dhe zotërimi i kuptimit të këtyre nevojave dhe prirjeve, të cilat janë në funksion të ndërtimit, konsolidimit dhe zhvillimit të qenies njerëzore dhe kombëtare shqiptare në rrafshin kulturor, shkencor dhe politik, përbën këpujën lidhëse, e cila e krijon unitetin e brendshëm të shumës së profileve të qenies intelektuale të Rexhep Qosjes. Të shfaqurit e qenies intelektuale në fusha të ndryshme veprimtarish shpirtërore të Rexhep Qosjes nuk ka lindur nga nevoja formale për të hartuar një listë nevojash imediate për ekzistencën e qenies kombëtare shqiptare, por është një nevojë e shtyrë nga nevoja për qartësimin dhe destinimin shoqëror të këtyre nevojave.

Aftësinë për të vendosur standarde të larta në kuadër të angazhimit të vet jetësor – në kuadër të punës intelektuale e krijuese – Rexhep Qosja nuk do ta zhvillojë vetëm duke u drejtuar nga racionaliteti emancipues që identifikon dhe zotëron kuptimin e nevojave dhe të prirjeve zhvillimore të qenies njerëzore e kombëtare shqiptare (si atribut i rëndësishëm i realitetit të qenies njerëzore), por edhe duke i zhvilluar aftësitë e racionalitetit emancipues për t'u mbështetur në struktura të qëndrueshme deontologjike e epistemologjike.

Ideja për Vetes si kusht i vetërefleksionit emancipues

Vetëreflektimi habermasian, si akt i njohjes që shpie në emancipim, është i pamundur pa përfshirjen e Vetes, si subjekt i njohjes dhe si subjekt që njeh. Vetëdija e të qenit subjekt dhe aftësia e vetëdijes për ta përkufizuar qartë karakterin e subjektit, përbën bazamentin e fuqisë vetëreflektuese, si rrugë për emancipim. Në këtë kontekst, mund të themi se të shfaqurit e qenies në fusha të ndryshme veprimtarish shpirtërore të Rexhep Qosjes, është kondicionuar

nga arsyeja emancipuese, e cila – për ndryshim nga arsyeja instrumentale me karakterin e saj përjashtues e marginalizues – me karakterin e saj integruar e gjithëpërfshirës, në njërin anë, do të veprojë e nxitur nga nevojat për kuptimin, vlerësimin dhe zotërimin e *idesë për Vetes* (kolektive në rrafshin politik, kulturo, historik, letrar, gjuhësor), si një e tërë e pandarë dhe, nga ana tjetër, duke drejtuar interesat emancipuese njohëse drejt identifikimit të nevojave që e përcaktojnë kahun e zhvillimit të pjesëve të Vetes në marrëdhënie me njëra-tjetrën dhe me të tërën.

Fuqitë reflektuese në krijimtarinë intelektuale e shpirtërore të Rexhep Qosjes janë në raport të drejtë me masën e saktësisë që ai do ta ketë për konceptin e Vetes, si epistemë, si dhe masës së përfshirjes së saj në procesin e vetërefleksionit, si objekt i njohjes dhe si subjekt që njeh. Në fushën e krijimtarisë letrare, i diktuar nga ndërgjegjia autentike krijuese, e jo e rreme, Rexhep Qosja do të na e “zbulojë” nga “fshheja” autenticitetin e ekzistencës së qenies së Vetes sonë. Ndërsa përmes krijimtarisë në fushën e shkencës së letërsisë Rexhep Qosja do të na i zbulojë fuqitë reale që letërsia shqipe ka përdorur për *prodhimin* e qenies së Vetes sonë në autenticitetin e ekzistencës së saj.

E kuptuar si një fuqi qëllimore, *Ideja për Vetes* në punën intelektuale të Rexhep Qosjes, do ta përcaktojë karakterin dhe funksionin e aparaturës njohëse të tij (si në fushën e krijimtarisë letrare ashtu edhe në atë shkencore), tipin e arsyes emancipuese, e jo të instrumentalizuar; karakterin emancipues të interesave njohëse, si dhe mjetet kognitive (konceptin për të vërtetën, teorinë dhe metodat). Në fakt *Ideja për Vetes* në punën krijuese të Rexhep Qosjes ontologjikisht do ta përcaktojë karakterin e *interesave njohëse* dhe *karakterin e së vërtetës*. *Ideja për veten* dhe *interesat njohëse* në krijimtarinë e Rexhep Qosjes reciprokisht janë të ndërlidhura. Ato e prodhojnë dhe e mirëmbajnë reciprokisht njëra-tjetrën. *Ideja për veten*, në veprimtarinë krijuese të Rexhep Qosjes, e përmban idenë për të vërtetën dhe idenë për lirinë, gjë kjo që arsyes emancipuese të tij do t'ia mundësojë identifikimin e *interesave të vërteta njohëse*, e kjo do të thotë se do t'ia mundësojë shënjimin dhe përkufizimin e saktë të objektit të njohjes (në fakt të problemit, zgjidhja e të cilit është përcaktues për emancipimin e vetëdijes që e kërkon sigurimin e mirëqenies fizike, morale e intelektuale të ekzistencës së Vetes përmes kërkimit të *kuptimit*), si dhe vënien në lëvizje të dëshirës (vullnetit) për zotërimin noetik të tij. Identifikimi i *interesave emancipuese njohëse*, në mënyrë të shkallëzuar, në krijimtarinë e Rexhep Qosjes do të prodhojë qartësi në zgjedhjen dhe përdorimin adekuat të kategorive kognitive (koncepteve, teorive, metodave, disiplinave).

I interesuar për ta kuptuar dhe vlerësuar realitetin e Vetes sonë në dimensionin e aktualitetit dhe të potencialitetit të saj, Rexhep Qosja në punën e tij operon me të vërtetën të konceptuar si proces i zhvillimit të së tërës, e jo si akt i pjesës (letrare, kulturore e politike). E vërteta është e tëra, e cila në konceptin hegelian, është esenca e cila përfundon me zhvillimin e vet. I drejtuar prej interesave njohëse emancipuese, e vërteta e tillë e fut në lëvizje përmeshjen e qëllimit të *idesë për Vetes* (si totalitet), në fakt të realizimit të saj, duke iu kundërvënë kritikisht shtrëngesave dhe kufizimeve që e pamundësojnë zhvillimin e saj.

Shtrohet pyetja: Çfarë është ajo që krijon kohezionin e brendshëm brenda një vetëdijeje të veçantë, si dhe ndërmjet vetëdijeve të ndryshme që e hasim brenda tërësisë së veprës së Rexhep Qosjes?

Doktrina epistemologjike e racionalizmit kritik

Racionalizmi kritik, si doktrinë epistemologjike, dhe iluminizmi, si botë-kuptim ndaj botës, përbëjnë platformën e përbashkët ku veprojnë vetëdijet e ndryshme njohëse të Rexhep Qosjes. Këto dy shtylla të platformës njohëse do të përcaktojnë karakterin, përmbajtjen, marrëdhëniet, rendin dhe funksionet e koncepteve teorike e estetike-letrare, historiko-letrare, kulturologjike e politike që Rexhep Qosja do t'i përfshijë në punën e tij krijuese. Racionalizmi kritik, si doktrinë epistemologjike dhe iluminizmi, si botë-kuptim për botën, janë nyja lidhëse në të gjithë rrjetin e angazhimit intelektual të Rexhep Qosjes: lidhjen ndërmjet mjeteve dhe qëllimeve, natyrës dhe funksioneve të objekteve, me anë të të cilave vetëdijet e ndryshme krijuese, duke vepruar në to, jo vetëm brenda vetes së tyre, por edhe në raport dhe në marrëdhënie me fushat e tjera arrijnë të krijojnë unitetin e brendshëm dhe individiumin shkencor e krijues të Rexhep Qosjes.

Racionalizmi kritik, si doktrinë epistemologjike, bazohet dhe drejtohet prej interesave të arsyes emancipuese, të cilat, në pikëpamjen e Habermasit – për ndryshim nga interesat praktike dhe teknike njohëse, që kanë të bëjnë me kontrollin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë në një bashkësi – kanë të bëjnë me fuqizimin e aftësive të individit dhe shoqërisë për të marrë kontrollin e jetës së tyre në mënyrë autonome dhe të përgjegjshme. Kritika buron nga interesat emancipuese njohëse, dhe vetëm përmes tyre ajo është e aftë të ngadhënjë mbi dogmatizmin. Arsyja emancipuese që drejtohet prej interesave emancipuese njohëse, në betejën midis kritikës dhe dogmatizmit, në secilën shkallë të emancipimit, do të arrijë fitore të re. Racionalizmi kritik do të jetë ajo platformë epistemologjike, e cila Rexhep Qosjen në angazhimin e tij shkencor e krijues do ta bëjë të jetë i hapur ndaj ideve të tjera, ndaj metodave dhe teorive, ndaj procedimeve të ndryshme krijuese letrare.

Përmasë racionalizmit kritik, Rexhep Qosja do ta vendosë një standard, me anë të të cilit do të bëhen të dukshme *nevojat reale* që e mundësojnë zhvillimin e *Vetes* sonë duke i përveçuar ato nga *nevojat false*, si dhe, përmes tij, të bëjë interpretimin e atyre nevojave. Mbi bazën e racionalizmit kritik ai do të arrijë t'i korrektojë gabimet dhe lajthitjet tashmë të çimentuara në mënyrat e gabuara të të konceptuarit dhe të të menduarit për letërsinë, për shkencën e letërsisë, për kulturën, për gjendjen politike shoqërore e historike, në të cilën do të jenë shqiptarët në gjysmën e dytë të shekullit XX dhe në fillim të shekullit XXI, në radhë të parë për shkak të idesë së shtrembëruar për *Veten*, e cila në Shqipëri do të vijë nga shtypja e diktaturës komuniste, ndërsa në Kosovë nga shtypja e kolonializmit të Jugosllavisë Avnojane. I udhëhequr nga arsyja emancipuese njohëse, Rexhep Qosja do t'iu kundërvihet nevojave të tregësive për *Veten* që, përmes arsyes empirike instrumentale në Shqipëri i diktonte dogmatizmi i ideologjisë klasore. Kolonializmi jugosllav, përmes arsyes instrumentale, *idenë për Veten* shqiptare, si kategori deontologjike në njohje, do ta njehsojë me vetëdijen kozmopolite. Kolonializmi jugosllav duke afirmuar racionalitetin teknik objektiv, që drejtohet nga njohja e "gjësë objektive", do ta pamundësojë emancipimin për shkak se do ta nxjerrë jashtë procesit të refleksionit *Veten*, si subjekt autentik njohës dhe si kusht i realizimit të tij. Përjashtimi i *Vetes*, si subjekt, e bën të parëndësishëm dhe të panevojshëm njohjen e vlerës së një gjëje. Kërkimi i objektivitetit shkencor në "gjënë", por pa *Veten* tonë, si objekt i njohjes dhe si subjekt njohës, është një teknicism i njohjes. Përderisa *Vetja* është në qendër të refleksionit letrar, shmangia e *Vetes* nga procesi i të menduarit shkencor për letërsinë do të thotë shmangie ndaj detyrës parësore të njohjes, në emër të objektivitetit. Objektiviteti që e përjashton *Veten*, është racionalizëm abstrakt, është racio-

nalizëm irracional, në thelb dogmatik.

Ideologjia klasore në Shqipëri, përkundër kolonializmit jugosllav *idenë për Veten*, si kategori deontologjike në njohje, do ta njehsojë me vetëdijen klasore. Çdo entitet tjetër njerëzor që do të bjerë në kundërshtim me vetëdijen klasore, do të konsiderohet si armike e idesë për *Veten* tonë. E vërteta, që bazohet në teorinë e përputhjes së vetëdijes klasore me realitetin empirik konsensual, do të jetë e vërtetë iluzore, e rrejshme. Teoria e tillë e shtrembëruar për të vërtetën do ta diktojë edhe qëndrimin e shtrembëruar që subjektet e refleksionit dhe e precesionit (në krijimtarinë shkencore dhe atë letrare) do ta kenë ndaj idesë për *Veten*. E ndodhur midis egos dhe vetëdijes joautentike, e vërteta e falsifikuar e idesë për *Veten* do të prodhojë precesione dhe koncepte të shtrembëruara për realitetin e *qenies së Vetes*, si në krijimtarinë shkencore ashtu edhe në atë letrare shqiptare. Konsideroj se këtu duhet kërkuar shkakun ontologjik të dështimit deontologjik të pjesës më të madhe të krijimtarisë (shkencore e letrare) që është krijari e ndikuar nga ideologjia klasore në Shqipëri. Sepse, krijimtaria e tillë, duke u bazuar në idenë e shtrembëruar për *Veten*, është vënë në shërbim të së vërtetës së shtrembëruar dhe idesë së shtrembëruar për *lininë*. Çdo formë e të menduarit, çdo formë e njohjes, e cila nuk përmban në vete qartësi dhe saktësi maksimale për idenë ndaj *Vetes*, së vërtetës dhe idesë së lirisë, gjithmonë do të jetë e predispozuar të jetë material për arsyen instrumentale, e jo emancipuese.

Në shkencën e letërsisë shqiptare, Rexhep Qosja, duke pasur qartësinë e duhur për idenë për *Veten*, si kusht i vetërefleksionit – përkundër shkencës së letërsisë që krijohet në Shqipëri, e cila, e diktuar nga ideja për *Veten* sipas kriterit të vetëdijes klasore, gjithë prodhimin letrar shqiptar që nuk do t'i përshtatet kësaj ideje, do ta lërë jashtë faqeve të historiografisë së letërsisë shqipe – qysh në gjysmën e dytë të viteve '60 do ta ngrejë nevojën për trajtimin e njësisë së letërsisë shqipe. Në gjysmën e dytë të viteve '80 dhe në vitet '90, në kontekstin e fillimit të rënies së ngrehinës të quajtur Jugosllavi, si askush prej klasës së atëhershme të inteligjencës shqiptare, Rexhep Qosja guximshëm do ta ngrejë nevojën e të ekzistuarit të shqiptarëve në një shtet të vetëm. Mund të thuhet se shkak i njohjes së prijevje dhe nevojave shpirtërore kombëtare, që e hasim në veprën kritike letrare të Rexhep Qosjes, buron prej qëllimit që përmban njohja e prijevje dhe nevojës së të zhvilluarit në mënyrë të njësisë të kombit shqiptar në një shtet të vetëm, që e hasim në veprën politike e publicistike të tij. Nuk është e vështirë për të hetuar këtu se pikëpamja për njësinë letrare e kulturore shqiptare korrespondon me pikëpamjen politike për bashkimin kombëtar, si kusht për zhvillimin kolektiv të shqiptarëve në perspektivën historike.

Vepra jetësore e Rexhep Qosjes dëshmon për një dinamikë komunikimi të vetëdijes shkencore me vetëdijen politike kombëtare të tij. Vetëdija e studiuesit të letërsisë, qysh në gjysmën e dytë të viteve '60, do të jetë përgjigjja prospektive e vetëdijes politike të intelektualit të angazhuar për fatet e kombit të vet në mesin e viteve '80 e deri më sot.

Përfundim

Fuqitë emancipuese nuk maten me masën e zbatimit të teorive, të metodave dhe shumësisë së këndvështrimeve. Fuqitë emancipuese njerëzore maten, në radhë të parë, nga forcat aktive të vullnetit që përmbajnë subjekte të caktuara për ta përkufizuar qartë idenë për *Veten* dhe interesat njohëse emancipuese. Forcat aktive të vullnetit në punën krijuese e intelektuale të prof. Rexhep Qosjes do të jenë motori që do ta vënë në lëvizje mendimin e tij në frontin e bërjes dhe vetëbërjes së *Vetes* sonë komb me vetëdije moderne kulturore.

Fusnotat dhe bibliografia janë hequr nga Redaksia

© KOHA Ditore

IN MEMORIAM: REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

Shqiptarët, gjithnjë të vonuar!

Si për paradoks, tani që Qosja ka mbyllur sytë, shqiptarët janë e mbeten të vonuar. Për trishtimin e tij e të të gjithë shqiptarëve që mendojnë. Këtu janë ngushëllimi dhe respekti për të, këtë mendje të paepur të së vërtetës kombëtare. Pa frikë e vendosi gishtin në plagën e madhe kombëtare, sikur ia drejtoi vetes: Si gjithnjë të vonuar



Mbijetesa e figurës së Qosjes nis tashmë, kur kritikëve do t'u duhet t'iu kthehen shqyrtimeve dhe analizave të tij letrare dhe politike dhe përpjekjes për ta harruar

Ben Andoni

Lajmi i para pak ditëve për vdekjen e prof. Rexhep Qosjes ngjalli më shumë kërshëri për përkorjen e lajmit dhe ceremonialit funebër tepër strikt, nëse mund të thuhet kështu për një ngjarje të tillë, sesa vetë ndarjen nga jeta të këtij personaliteti të shquar! Sikur ta kishte ndier, por edhe dëshiruar për nderimin e tij (distancimin), edhe në atë ditë të mbrame shqiptarët e këtej kufirit përplaseshin pa sens në parlament, e shumë afër tij, në një kufi tjetër, n'Kosovë kulisonin për zgjedhjen e një presidenti, i cili prej muajsh përlitit dhe kulisohej më kot. Megjithatë, Apeli i Ndërgjegjes e bëri Parlamentin shqiptar të mbante zi për të, kurse Kosova të shpallte zyrtarisht një ditë zie kombëtare. Këtu merr fund, të themi kthimi i nderit ndaj tij. Prof. Qosja, vetë, e pati më të lehtë, qysh në të gjallë, duke paraprirë disi lajmet e hidhura dhe kaosin tonë, të linte amanetin që të varrosej ashtu thjesht. Pastër. Qetë. "Harruar". Veç, pa politikanë. Pa vajtovica. E, pa fjalimmbajtës patetikë.

Mbijetesa e figurës së Qosjes nis tashmë, kur kritikëve do t'u duhet t'iu kthehen shqyrtimeve dhe analizave të tij letrare dhe politike dhe përpjekjes për ta harruar. Për fat, pjesa më e madhe e këtij qëndrimi është lënë e dokumentuar përmes një kolane të tërë, që përbën ditarin dhe krijimtarinë e tij, ku mund të shqyrtohet diagrama e perceptimeve, qëndrimeve, emocioneve dhe realiteti i tyre, por nga ana tjetër edhe bashkëkohësia e shumë gjërave të tij.

Qosja nuk e konsideronte veten si zëri i vetëm dhe sublim i Ndërgjegjes Kombëtare, por me atë që krijoi, debatoi dhe kumtoi, tregoi se kishte atributet (me formimin mund ta artikulonte atë si pakkush) të tregonte atë që ndër vite shqiptarët e kishin përballur, shpesh edhe pa ditur ta përtpynin si duhet. Më së vështiri për të mbeti ndriçimi i mendimit të bashkëdhetarëve dhe gjetja e pikave, ku mund t'u flitej për kultivimin bashkëkohor. Dhe, shqiptarët duhet t'i kujtosh vazhdimisht për Vetëdijen, larg patetizmit, ku masë e autoritetit

moral është e duhet të mbetet atdheu dhe zhvillimi i tij.

Vetëdija historike mbështetet në tri parime të mëdha, ku i pari mbetet ndryshimi, atë që Qosja e trajtoi në aspekte të ndryshme të çështjes shqiptare, duke kërkuar ta bënte sa më të përshtatshme për kohën. Kontributi i tij në vitet '70, '80 dhe '90 e më vonë, kur çështja e Kosovës ende nuk ishte formësuar, do të jetë masë për kritikët për ta shqyrtuar rolin e tij, ashtu si do të ndodhte në parashikimet e tij për mëvetësinë që kulmuan me 17 Shkurtin e vitit 2008 me aktin e madh të pavarësisë; e dyta me kontekstin që përbën një komponent vital të vetëdijesimit historik për një komb. Këtu Qosja polemizoi me shumë shqiptarë qeveritarë dhe mendimtarë të letrave. Do të jetë i ashpër deri me Kadarenë, paçka se hera-herës mes tyre do të ketë shprehje të larta konsiderate, ndërsa debati i tyre do të përshkallëzohet sërish para disa vitesh deri në një agresivitet intelektual. E gjitha në thelb do të tregojë se çështja shqiptare ende ka nevojë për maturim, kur edhe mes personaliteteve të tilla ka perceptime të ndryshme. Pa asnjë mëdyshje nuk do t'i ndahet Berishës, si një nga njerëzit më historikë të Shqipërisë post '90, duke e konsideruar sjelljen e tij ndaj Kosovës, t'ngjashme me atë të Ahmet Zogut. Megjithatë vdekja harro shumë gjëra. Berisha do ta vlerësojë pak orë më parë: "Kultura, mendimi letrar dhe shoqëror e politik shqiptar, polemika dhe letrat shqipe humbën një kolos të tyre, autor të një serie veprash në këto fusha".

Qosja do ta kontekstualizojë çështjen shqiptare, kundër gandizmit gati servil të Ibrahim Rugovës dhe njerëzve të tij, do të ketë përballje dhe bashkëpunim me Adem Demaçin, ndërkohë do ta vijojë me shumë kujdes kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare për Kosovën. Dhe, do të dijë të mbajë qëndrim për një nga problemet më të mëdha të identitetit tonë: standardin e shqipes, që në vitet e para '90 u kërkuu të ndryshohej. E mbron standardin, por për një ish-doktorantin e tij Sedaj, që e artikulon si tezë kundër, edhe pse nuk është dakord e vlerëson se: ngriti zërin kur

iu cenia e drejta e shprehjes së lirë. Ky quhet dinjitet, por edhe arsye. Kjo është cilësia e njerëzve që ndajin perceptimet me idetë dhe bindjet.

Veçse nuk do të harrohet me vite mllëfi ndaj profesorit nga Shqipëria, por sidomos në Kosovë. "Po zhvillohet një fushatë tepër e paskrupuj kundër meje, kundër Adem Demaçit, kundër Bujar Bukshit, dhe kundër Bajram Kosumit, por posaçërisht e poshtër është ajo fushatë kundër meje", shkruan diku me trishtim...Befas, në një shënim të 28 dhjetorit 1997 shkruan atë që në Kosovë është e sotmja dhe përbën pengesën më të madhe: "Ngadalë, por pandalshëm, partitë po e pengojnë rolin e inteligjencës krijuese në jetën shoqërore, politike dhe kombëtare në përgjithësi". Dhe, aspekti i tretë i vetëdijes historike, citojmë historianin John Tosh është njohja e procesit historik apo i marrëdhënieve ndërmjet ngjarjeve dhe kohës. Këtë prof. Qosja e bën si patriot, por edhe si mendimtar, duke përsiatuar mbi vonesat tona përgjatë të gjitha kohërave. E shpreh jo thjesht me dhimbje se jemi të vonuar dhe do të mbesim të tillë, por do të alarmojë, atë që në fakt e ka bërë qysh në tetor të vitit 1990, kur do të shkruante: "Shqipërisë i duhen ndryshime rrënjësore, por unë dëshiroj që ato ndryshime Shqipëria t'i bëjë duke ecur vertikalisht. Vetëm ashtu vertikalisht mund të mos vonohet në ardhmërinë. Për këto bindje të mia e kam dëshmitare historinë tonë". Të mos harrojmë, u shkruan në kapërcyell të shekullit të shkuar, kur Kosova nuk ishte ende shtet dhe Shqipëria po shikonte rrezet e para të agut demokratik...Si për paradoks, tani që Qosja ka mbyllur sytë, shqiptarët janë e mbeten të vonuar. Për trishtimin e tij, e të të gjithë shqiptarëve që mendojnë. Këtu janë ngushëllimi dhe respekti për të, këtë mendje të paepur të së vërtetës kombëtare. Pa frikë, e vendosi gishtin në plagën e madhe kombëtare, sikur ia drejtoi vetes: Si gjithnjë të vonuar. Ne të gjallët, sot, na mbetet thjesht ta nderojmë dhe...t'i themi me shpirt: I qoftë dhe i lehtë!

© KOHA Ditore

IN MEMORIAM: REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

Arratisja nga vendi i kaosit etnik

Intervistën me akademik Rexhep Qosjen që po e sjellim para lexuesve e ka zhvilluar gazetari Jovan Radovanović dhe ajo është botuar në dy vazhdimë: më 12 dhe 13 dhjetor të vitit 1991, në të përditshmen beogradase “Borba”. Është njëra ndër intervistat e para, por edhe të rralla të kohës, e publikuar në shtypin “jugosllav” në të cilën akademik Qosja e shpalos platformën e tij për zgjidhjen e “Çështjes shqiptare” në ish-Jugosllavi. Kujtojmë se në ato vite opinionet e krerëve të “alternativës kosovare” nuk arrinin të gjenin hapësirë në shtypin ndërkombëtar në radhë të parë për shkak të luftërave që kishin shpërthyer në ish-republikat jugosllave. Qëndrimet e akademik Qosjes të shpalosura në të përditshmen “Borba” të Beogradit, ashtu edhe siç pritej, nuk i shpëtuan fushatës së njohur antishqiptare të shtypit serb, të kontrolluar nga Sllobodan Millosheviqi

MST: “Shqiptarëve u është imponuar sovraniteti jugosllav”

“Sovraniteti jugosllav për shqiptarët është një sovranitet i imponuar dhe i dhunshëm. Ne nuk do të qetësohemi derisa të marrim statusin e kombit dhe Serbia duhet të ketë frikë nga vetja. Është në interes të të dy popujve, si atij serb ashtu edhe shqiptar; të heqin qafe regjimin e Millosheviqit”, ka thënë akademik Rexhep Qosja në fillim të bisedës duke vazhduar se “Jugosllavia tashmë është në një proces të përsheptuar të shpërbërjes. Pra, nuk mund të flasim më për Jugosllavinë. Për momentin, ekziston ose ndoshta do të krijohet një lloj Jugosllavie e vogël, gëgjësisht Serbia e Madhe, por Jugosllavia nuk do të ekzistojë më. Jugosllavia ishte një gabim në historinë e Ballkanit dhe historia tani po e korrigjon atë gabim. Disa historianë kanë thënë se Jugosllavia ishte krijuar nga kaosi etnik dhe shpërbërja e saj ishte e pashmangshme. Kanë ikur kohët e perandorive dhe federatave artificiale. Prandaj, fati i Jugosllavisë është i lidhur me fatin e Bashkimit Sovjetik dhe të Çekosllovakisë. Nëse lejohet ekzistenca e Serbisë së Madhe, atëherë ky do të jetë një gabim edhe më i madh historik. Evropa do të detyrohet të ndërtojë edhe një tjetër padrejtësi, një tjetër iluzion, kundër të cilit, në të vërtetë, sot janë ngritur forcat e saj demokratike”.

Kështu i përgjigjet pyetjes sonë njëri prej intelektualëve më të shquar shqiptarë nga Kosova, akademiku Rexhep Qosja, i cili shihet si figura kryesore midis atyre shqiptarëve “radikalë” që po mbrojnë gjithnjë e më shumë opsionin e bashkimit të Kosovës me shtetin e Shqipërisë. Tani dhe menjëherë në vijim, Qosja thotë: “Shqiptarët nuk kanë asgjë për t’u ankuar për Jugosllavinë, megjithëse në shikim të parë duket se shpërbërja e saj pengon zgjidhjen e çështjes së tyre kombëtare, sepse në vend të një shteti, Jugosllavisë, Shqipëria dhe shqiptarët do të duhet të negociojnë me tri shtete – Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Pavarësisht sjelljes politike që na është imponuar që nga viti 1912 – kur territori shqiptar u pushtua nga Serbia dhe Mali i Zi, domethënë që nga viti 1918 – kur u krijua Jugosllavia, sovraniteti jugosllav për ne ka qenë dhe ka mbetur një sovranitet i imponuar dhe i dhunshëm. Mirëpo me shpërbërjen e Jugosllavisë, çështja kombëtare shqiptare në skenën politike ballkanike dhe evropiane aktualizohet si një çështje e vështirë, tragjike dhe kombëtare dhe më të cilën duhet të merren institucionet evropiane dhe ndërkombëtare. Parë historikisht, me shpërbërjen e Jugosllavisë nis ndërtimi i bashkimit kombëtar shqiptar. Kjo është logjika e historisë – vdekja e një shteti sjell në jetë disa shtete të tjera”.

Ju jeni njëri nga udhëheqësit e Forumit të Intelektualëve Shqiptarë. Deri vonë, thuhej se intelektualët shqiptarë po heshtin, por tani më nuk mund të thuhet kështu, sepse ata i kanë formuluar qëndrimet e tyre. Cilat janë ato qëndrime?

Qosja: Unë nuk jam udhëheqësi, asnjë nga udhëheqësit e ndonjë partie, as të ndonjë shoqate apo forumi. Në njëfarë mënyre nuk mundem të bëhem njëri i organizatës, i partisë. Njeriu i organizatës duket se



Rexhep Qosja: “Serbia duhet ta ketë të qartë njëherë e përgjithmonë: se në Kosovë ishte dhe mbetet një shtet pushtues. Ne kurrë nuk do të kemi një ndjenjë tjetër ndaj saj. Serbia nuk do të jetë në gjendje t’i marrë parasysh gjëra të tilla: ndjenjat e popullit shqiptar, sepse ndjenja të tilla po formohen gjithnjë e më me vendosmëri në politikën kombëtare të popullit shqiptar në tërësi”

pushon së qeni njëri i shpirtit. Organizimi, domethënë partia, është pjesë e popullit, e cila u vihet kundër organizatave, partive të tjera, që do të thotë pjesëve të tjera të popullit! Ndërsa unë dua të jem njëri i shpirtit, që do të thotë njëri që komunikon shpirtërisht, pra vetvetiu komunikon politikisht, me të gjithë kombin. Nga pikëpamja politike mund të tingëllojë e pahijshme, por nga pikëpamja intelektuale – më shumë se e nevojshme. Intelektualët shqiptarë tashmë i kanë formuluar pikëpamjet e tyre: kombëtare dhe politike. Dhe të gjithë jemi pajtuar për dy gjëra: së pari, shqiptarët nuk do të qetësohen derisa të njihen si komb, që do të thotë ta gëzojnë të drejtën e vetëvendosjes, dhe së dyti, partitë janë mekanizma që degjenerojnë, kështu që duhet të ketë intelektualë që do t’ia thonë të vërtetën popullit.

Nuk frikësohemi, por ruhem nga Serbia

Pikëpamjet e intelektualëve të pavarur shqiptarë, në raport me partitë politike, kur bëhet fjalë për Konferencën e Hagës, ndryshojnë. Ju lutem shpjegoni lexuesve se cilat janë këto dallime?

Qosja: Partitë politike të shqiptarëve në Jugosllavi nuk u shfaqën thjesht në Hagë, sepse partitë politike të shqiptarëve të Kosovës u shfaqën si një entitet politik më vete, dhe partitë politike të shqiptarëve nga Maqedonia gjithashtu u shfaqën si një entitet politik më vete. Kështu mund të shfaqeshin edhe partitë politike të shqiptarëve nga Mali i Zi, domethënë Serbia jugore (Presheva, Bujanovci, etj.). Shumica e intelektualëve besojnë se shqip-

tarët duhej të ishin paraqitur si një subjekt politik unik, nëpërmjet përfytyrës legjitime që ata do t’i zgjidhnin vetë. Sepse çështja kombëtare shqiptare në Jugosllavi ekzistonte si një çështje unike kombëtare. Italianët, që jetojnë në Slloveni dhe Kroaci, hungarezët që jetojnë në Serbi, Kroaci dhe Slloveni, dhe myslimanët që jetojnë në Serbi dhe Mal të Zi (në Sanxhak) në Hagë u paraqitën të gjithë në mënyrë unike. Në përputhje me një paraqitje jounike të subjekteve politike shqiptare në Konferencën e Hagës, partitë politike të Kosovës, apo Kuvendi i Republikës së Kosovës, në fund të shtatorit organizoi referendum vetëm të shqiptarëve të Kosovës. Shumica e intelektualëve shqiptarë besojnë se, pavarësisht pengesave, duhej të ishte organizuar një referendum i të gjithë i shqiptarëve në Jugosllavi. Sepse, në

Hagë, është duke u vendosur për Jugosllavinë dhe jo vetëm për një republikë apo një popull.

A kanë frikë shqiptarët nga Serbia?

Qosja: Serbia duhet të ketë frikë nga vetja, sepse vetëm në këta dhjetë vjetë e fundit, ajo u ka shkaktuar një oqean të këqijash shqiptarëve: padrejtësi, dhunë, abuzim, grabitje, persekutim, dëbim, rrahje, lëndime, vrasje, e kështu me radhë. Shqiptarët nuk kanë frikë nga Serbia, por shqiptarët kanë kujdes ndaj Serbisë! Ne jemi të kujdesshëm. Serbia e ka armatën, dhe ajo ushtri deri dje ishte Armata Popullore Jugosllave. Dhe ajo armatë është e armatosur deri në dhëmbë. Serbia ka forca të mëdha policore, dhe ato forca policore, kur ka nevojë, mund të armatosen edhe me pajisje ushtarake. Serbia ka Mbrojtje Territoriale. Serbia i ka armatosur deri në dhëmbë serbët dhe malazezët në Kosovë. Me një fjalë, Serbia është shtet ushtarako-policor, d.m.th. militarist. Ndërsa në anën tjetër, Serbia i vret dhe i persekuton shqiptarët vetëm për shkak të një revoleje. Serbia u zgjerua në Kosovë me ndihmën e ushtrisë, u mbajt nga ushtria dhe policia deri më sot, dhe Serbia mendon që edhe në të ardhmen në Kosovë të mbahet nga ushtria dhe policia. Shpresojmë se nuk do t’ia dalë që të ketë sukses për një kohë të gjatë në këtë drejtim, sepse mbajtja ushtarako-policore e shteteve sot është në kundërshtim me lëvizjet demokratike evropiane dhe në kundërshtim me arsyen historike. Por derisa lëvizje të tilla të arrijnë në Serbi dhe derisa një arsye e tillë të mbizotërojë mbi Serbinë, regjimi agresor serb mundet që për një kohë të shkurtër këtu të krijojë një kasaphanë të madhe në Kosovë, në të cilën nuk do të ishte e mundur të njiheshin cilat do të ishin kufomat shqiptare dhe cilat serbe. Për këtë është në interes jo vetëm të popullit shqiptar, por edhe të popullit serb, që Serbia të çlirohet nga regjimi i sotëm i Millosheviqit, i cili e ka shndërruar Serbinë në një shtet agresiv, militarist – shtetin më të urreyer në botën e sotme, i cili po bëhet i rrezikshëm për të gjithë Ballkanin, madje edhe më gjerë, sepse po përpiqet të arrijë integrimin në bazë fetare me Greqinë, Malin e Zi, Rumaninë dhe Bullgarinë nën protektoratin e Rusisë.

Pajtimi kombëtar është domosdoshmëri historike

Cili mund të jetë ndikimi i mbërritjes së “helmetave të kaltra” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Jugosllavi në zgjidhjen e problemit të Kosovës?

Qosja: Jugosllavia është në luftë civile, e cila është etnike, fetare dhe politike dhe, së shpejti, mund të jetë edhe ndërshtetërore. Dhe ajo luftë kërcënon të zgjerohet gjithnjë e më shumë. Ardhja e “helmetave të kaltra” do t’i kursente popujt e ish-Jugosllavisë nga zgjerimi i kësaj lufte. Dhe, mbërritja e “helmetave të kaltra” do të sillte edhe më shumë shpresë në Kosovë për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Apo, për fillimin e zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare.

Cilat janë qëllimet e Kuvendit të Pajtimit dhe Bashkimit të Shqiptarëve, për të cilin është shkruar dhe folur ditët e fundit?

Qosja: Për disa muaj, po bëhen përpjekje që shqiptarët të tubohen në Kuvendin e Pajtimit dhe Bashkimit Kombëtar, pra në Kuvendin Gjithëshqiptar. Shqiptarët nuk janë kombi i parë, dhe nuk do të jenë kombi i fundit evropian që përpjetojnë arrijë pajtimin kombëtar. Pajtimet kombëtare në momente të caktuara janë një domosdoshmëri historike, por edhe pjekuri historike e një kombi. Dhe shqiptarët tani gjenden në një moment të tillë historik kaq dramatik. Më shumë se çdo komb tjetër evropian, shqiptarët sot kanë nevojë për një Kuvend të tillë Mbarëkombëtar për shkak të padrejtësive të mëdha që popullit shqiptar i janë bërë nga fqinjët, dhe mbi të gjitha nga Serbia, ai ka mbetur një komb i ndarë, madje i përçarë deri më sot. Ajo ndarje e popullit dhe e vendit, i ka dobësuar energjitë kombëtare, mundësitë për zhvillim. Kjo ka ndikuar që shqiptarët sot të jenë popull më i varfër në Evropë. Shqiptarët në Kosovë, në kuptimin e mirëfillt të fjalës, sot janë një popull i shtypur dhe i robëruar. Kosova është nën “gjendje rrethimi”. Megjithatë, Shqipëria, si pasojë e dekadave të diktaturës staliniste, po përjeton një krizë të vështirë politike, ekonomike, sociale dhe morale. Shqipëria është në një përçarje të madhe, madje tragjike politike. Ka një numër të madh shqiptarësh në botë që e gjetën veten atje, disa për shkak të persekutimit politik në Jugosllavi dhe në Shqipëri, dhe disa për shkak të varfërisë sociale. Siç mund ta shihni, ka shumë arsye që shqiptarët të mblihdhen në Kuvendin Mbarëkombëtar të Pajtimit. Dhe unë shpresoj se ne do të mblihdhemi në atë kuvend. Qëllimi i kuvendit është pajtimi kombëtar, që e gjithë energjia intelektuale, politike dhe morale e popullit të orientohet drejt realizimit të qëllimeve kryesore: zgjidhjes së drejtë të çështjes kombëtare, kapërcimit të krizës në të cilën ndodhet Shqipëria, dhe ndërtimit dhe institucionalizimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit të popullit shqiptar. Megjithatë, të gjithë jemi të vetëdijshëm se qëllimet që Kuvendi Mbarëkombëtar Shqiptar do t’ia ven dosë vetes nuk janë një ngjarje që mund të përfundojë menjëherë, por një proces që do të kërkojë kohë.

Pjesa e dytë e intervistës e publikuar më 13 dhjetor 1991:

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje në opinionin jugosllav, në një intervistë për gazetën “Borba”, paraqitet akademik kosovar, Rexhep Qosja, i cili i sqaron pikëpamjet e krahut “radikal” të intelektualëve shqiptarë, të cilët sot vendosin si qëllim të tyre bashkimin me shtetin e Shqipërisë, tani dhe menjëherë. Zotëri Qosja dje i shpjegoi arsytet e Kuvendit Mbarëshqiptar, për të cilin pati shumë reagime në mediat jugosllave. Kjo është arsyeja pse pyetja jonë e parë, në vazhdim të bisedës, ishte:

Cilat forca politike janë pro atij Parlamentit dhe cilat janë kundër tij?

Me kë është i mundur dialogu?

Duke pandehur se në një kohë jo të largët është i mundur dialogu midis serbëve dhe shqiptarëve, në cilat qarqe të intelektualëve dhe politikanëve serbë ju i shihni partnerët për dialog?

Qosja: Duke supozuar se dialogu midis shqiptarëve dhe serbëve është i mundur, unë i shoh partnerët për dialog patriotët e singertë serbë. Megjithatë, nuk i konsideroj patriotë serbë ata politikanë dhe intelektualë serbë që e përdorin Kosovën si kapital politik për të mbledhur pikë politike dhe për të krijuar autoritet të përkohshëm politik si patriotë serbë. Unë i konsideroj si patriotë serbë ata intelektualë dhe politikanë serbë që ndonjëherë, edhe pse me gjysmë zëri, thonë për shkak të asaj që po bën Serbia atje, Kosova është një turp serb dhe thonë me zë të ulët se parimet e drejtësisë, të drejtave dhe demokracisë po kompromentohen në Kosovë; që ndiejnë dhe thonë me zë të ulët se Serbia po përjeton një disfatë qytetëruese në Kosovë; që ndiejnë dhe thonë se Serbia në mënyrë të pashmangshme do të përjetojë një disfatë politike dhe historike në Kosovë; dhe që prej shqiptarëve nuk kërkojnë të jenë subjekte të nënshtruar, por fqinj sovran.

Qosja: Për Kuvendin Mbarëshqiptar kryesisht janë forcat politike që janë në pushtet në Shqipëri dhe pjesa më e madhe e popullit shqiptar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në diasporë. Forcat politike në pushtet janë për Kuvendin Mbarëshqiptar, sepse mendojnë se do t’i tubojnë disa pikë politike për zgjedhjet e ardhshme, ndërsa dhe populli është “për”, sepse mendohet që me pajtimin kombëtar mund të ndalet thellimi i mëtejshëm i krizës në shoqërinë shqiptare. Kundër Kuvendit Mbarëshqiptar nuk është askush, por për shtyrjen e datës së mbajtjes janë disa parti opozitare në Shqipëri dhe disa parti në Kosovë. Partitë opozitare të Shqipërisë, sipas bindjes sime të thellë, kanë frikë të panevojshme se partia në pushtet do të nxjerrë përfitime politike nga Kuvendi Mbarëshqiptar. Sepse prej këtij Kuvendi në fakt dobi mund të ketë vetëm një faktor: kombi shqiptar mbi kurrizin e të cilit po thyhen përçarjet politike, fërkimet, papajtueshmëritë e partive politike, të cilat kërkojnë gjithçka, por gjithçka, për vete, qoftë në përpjekje për të mbajtur pushtetin ose në përpjekje për të fituar pushtetin, duke harruar kështu përvojat e fundit politike: pikërisht të atyre që kërkuar gjithçka dhe e morën nga pushteti dhe ia sollën fatkeqësitë më të mëdha popullit të tyre.

Një akt demokratik me moral të lartë

Cilat forca intelektuale janë “për” dhe “kundër” Kuvendit Mbarëshqiptar?

Qosja: Me përjashtim të një numri shumë të vogël të atyre që ishin në shërbim të regjimit të mëparshëm në Shqipëri, ose atyre që luftuan kundër “kundërrevolucionit”, ose që e pritën vitin 1990 në Kosovë në heshtje të thellë, dhe tani me retorikën “demokratike” ata luftojnë kundër frikakallëkut të tyre të djeshëm, nuk ka intelektualë të tjerë shqiptarë që deklarohen kundër Kuvendit Mbarëkombëtar. Megjithatë, duhet theksuar se përkrahësit më të qëndrueshëm të Kuvendit janë intelektualët më të shquar shqiptarë, si dhe ata që vuajtën padrejtësi dhe dhunë, d.m.th. që me jetën ose vepërën e tyre përhapen pikëpamjet e demokracisë te popullit shqiptar si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë. Dhe këtu nuk ka asgjë të çuditshme. Kuvendi Mbarëshqiptar është një akt demokratik shumë moral dhe ata që sakrifikuan në një mënyrë ose në një tjetër për hir të demokracisë, që do të thotë për lirinë e popullit të tyre, nuk mund t’i qëndrojnë kundër. Sepse ata nuk merren me kalkulime politike dhe demagogji: ata thjesht janë të orientuar drejt së ardhmes, e cila përcakton si mendimin ashtu edhe sjelljen e tyre politike dhe shoqërore.

A është e vërtetë se ju më tepër e promovoni bashkimin e Kosovës me Shqipërinë sesa Republikën e Kosovës?

Qosja: Është e saktë. Deri në këtë vit, deri në luftën serbo-kroate dhe shpërbërjen e Jugosllavisë, shumë shqiptarë besonin se duke e çuar përpara statusin politik dhe kushtetues-juridik të Kosovës në Republikë, mund të sigurohej barazia e një pjese të popullit shqip-

tar në Jugosllavi dhe kështu, deri diku, mund të qetësoheshin ndjenjat kombëtare shqiptare. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që me krijimin e Republikës së Kosovës do të zgjidhet çështja kombëtare shqiptare. Jo. Çështja kombëtare shqiptare në Jugosllavi është më e gjerë se çështja e Kosovës. Sot, është e qartë për të gjithë se Republika e Kosovës në asnjë rast nuk e zgjidh çështjen kombëtare të Kosovës, e lëre më çështjen kombëtare shqiptare. Jugosllavia pa Slloveninë, Kroacinë dhe Maqedoninë ose Jugosllavia vetëm pa Slloveninë dhe Kroacinë nuk do të jetë një Jugosllavi e vogël, por një Serbi e Madhe. Dhe të qenët nën sovranitetin e Serbisë, pavarësisht se si do të quhet ajo, çfarë kufijsh dhe si do të ishte e organizuar politikisht kushtetutërisht-ligjërish, për ne shqiptarët do të thotë të jesh nën OKUPIM. Serbia duhet ta ketë të qartë njëherë e përgjithmonë: se në Kosovë ishte dhe mbetet një shtet pushtues. Ne kurrë nuk do të kemi një ndjenjë tjetër ndaj saj. Serbia nuk do të jetë në gjendje t’i marrë parasysh gjëra të tilla: ndjenjat e popullit shqiptar, sepse ndjenja të tilla po formohen gjithnjë e më me vendosmëri në politikën kombëtare të popullit shqiptar në tërësi.

Për ne është e vështirë, vërtet e vështirë me Serbinë, por edhe për Serbinë do të jetë gjithnjë e më e vështirë me ne. Ne kemi ku të shkojmë nga Kosova. Serbia ka bërë disa përpjekje historike, politike, ushtarake dhe shtetërore për të na nxjerrë nga Kosova, por nuk ka pasur sukses, sepse ne kemi qenë pjesë e këtij vendi për mijëra vjet, rrënjët tona janë aq të thella këtu saqë ne kurrë nuk mund të shkëputemi prej kësaj toke. Më pastaj, i gjithë opinionin publik botëror gjithnjë e më shumë ka mirëkuptim për të vërtetën dhe të drejtat legjitime të shqiptarëve. Serbia do të jetë gjithnjë e më e shqetësuar për Kosovën për shkak të presionit të opinionit publik botëror: duke qenë absolutisht pa asnjë argument – as historik (sepse e drejta historike shqiptar në Kosovë është më e vjetër se ajo serbe), as demografik (sepse shqiptarë ka me dhjetëra herë më shumë sesa serbë dhe malazezë në Kosovë), as politik (sepse shqiptarët si komb shumicë kanë të drejtën e vetëvendosjes politike dhe territoriale). Pra, Serbia nuk mund ta justifikojë sovranitetin e saj shtetëror mbi Kosovën.

Loja brutale me faktet politike

Qosja: Serbia nuk mund ta justifikojë me të drejta historike praninë e saj shtetërore në Kosovë dhe praninë e saj shtetërore me të drejtën etnike në Vojvodinë, e cila historikisht ishte Hungari. Serbia nuk mund të luftojë për të vërtetuar të drejtën e vetëvendosjes së serbëve në Kroaci, në ato territore ku ata janë shumicë, dhe t’ua mohojë me forcë të njëjtën të drejtë shqiptarëve në Kosovë, të cilët janë shumicë absolute këtu. Serbia nuk do të jetë në gjendje të luajë me faktet politike kaq brutalisht pa ngritur kundër vetes edhe më shumë opinionin publik botëror, sanksionet politike dhe ekonomike botërore dhe ndoshta ushtarake. Nëse populli serb dëshiron të vlerësohet si popull demokratik, nëse populli serb dëshiron të vlerësohet si popull liridashës, nëse Serbia nuk dëshiron të jetë një shtet pushtues, atëherë duhet të bëjë atë që opinionin publik evropian dhe amerikan thënë të drejtën tani me gjysmë zëri po e kërkojnë – pra t’ia lejojë të drejtën e qytetërimit demokratik popullit shqiptar të Kosovës që ai të vetëvendosë politikisht dhe territorialisht. Dhe kjo do të thotë “t’i lejohej atij të bëjë atë që është e natyrshme dhe e drejtë të bëjë – të bashkohet me popullin e vet në Shqipëri; t’i lejojë atë që ua jep natyra të jenë bashkë”. Serbia të shqiptarët kurrë nuk do të ketë qytetarë që e shohin atë si shtetin e tyre, por sigurisht që do të ketë fqinj të mirë shtetin shqiptar, të cilit do t’i përkasë edhe Kosova. Serbia nuk do të jetë në gjendje t’i mbajë shqiptarët në pozicionin e pakicës kombëtare. Nëse kjo do të jetë ashtu, parë historikisht edhe për

Vetëvendosja

Pikërisht për faktin se akademik Qosja njihet si promotor i zgjidhjeve “radikale” për Kosovën, në një moment e pyetëm nëse besonte në mundësinë e një zgjidhjeje paqësore të problemit të Kosovës.

“Në rendin politik botëror që po lind” – u përgjigj Qosja – “çështjen e Kosovës, apo çështjen shqiptare, do ta zgjidhë vetë vetëdija shqiptare: këmbëngulja dhe vendosmëria e popullit shqiptar do të vazhdojë përballë vuajtjeve derisa të arrijë të drejtën që i takon legjitimisht si populli shumicë e Kosovës: të drejtën për vetëvendosje politike dhe territoriale. Madje jam i prirë të besoj se opinionin publik serb, përfundimisht do të bëhet më i hapur ndaj një të drejte të tillë të popullit shqiptar dhe do të heqë dorë nga Kosova ashtu siç hoqën dorë francezët nga Algjeria, ashtu siç heqin dorë rusët nga kolonitë e tyre në Bashkimin Sovjetik sot”.

Serbinë, dhe jo vetëm për shqiptarët, është më mirë të pajtohen me bashkimin e shqiptarëve, sepse vetëm me bashkimin e shqiptarëve, çështja kombëtare shqiptare hiqet nga rendi i ditës edhe për Serbinë.

Pluralizmi tani është i dukshëm edhe në Kosovë. Jam i informuar se në këtë moment në Kosovë ka 15-16 parti politike. A është kjo një shenjë e dinamikës politike të Kosovës?

Qosja: Ndoshta në këtë moment ka shumë parti politike në Kosovë, por për mua ky numër nuk tregon shumë për dinamizmin e jetës politike në Kosovë.

Sa demokraci ka në pluralizmin aktual politik në Kosovë? Sa në Jugosllavi?

Qosja: Kosova është nën rrethim. Për çfarë lloj demokracie mund të flasim këtu? Një situatë e tillë nuk lejon që jeta jonë e brendshme politike të zhvillohet në mënyrë demokratike. Serbia u lejon partive tona politike aq aktivitet sa duhet për t’i treguar botës se megjithatë në Kosovë ka demokraci politike. Kështu pluralizmi politik i Kosovës instrumentalizohet në shërbim të Serbisë. Megjithatë, më tepër demokraci, nuk shihet diku tjetër: as në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi. Për shembull, Serbia i ka rreth 60 parti, por megjithatë, atje akoma mbretëron sundimi njëpartiak. Sepse, në parlamentin “shumëpartiak” serb, të gjitha ligjet dhe masat vendosen nga socialistët e konvertuar nga Lidhja e Komunistëve të Serbisë. Demokracia serbe sot është një demokraci gjysmëkulturore ku mbretëron demagogjia, gënjeshttrat dhe dhuna.

Sipas mendimit tuaj, sa janë të profilizuara politikisht partitë në Kosovë kur bëhet fjalë për qasjen ndaj zgjidhjes së “Njëës së Kosovës”?

Qosja: Sot, të gjitha partitë politike shqiptare kanë afërsisht të njëjtin qëndrim ndaj çështjes së Kosovës. Dhe ato e shprehin këtë qëndrim në deklaratën e Këshillit Koordinues të partive politike shqiptare në Jugosllavi. Megjithatë, deri më tani ka pasur disa dallime midis partive tona në lidhje me çështjen e Kosovës. Shqiptarët nuk i quajnë partitë e tyre kështu së koti: Partia Parlamentare e Kosovës – Lëvizja për Jugosllavinë. Partia Socialdemokrate e Kosovës – Lëvizja për Serbinë. Lidhje Demokratike e Kosovës – Lëvizja për Autonominë e Kosovës.

Mbetje anakronike të vetëqeverisjes

Dihet se në Kosovë u bënë përpjekje për të formuar Këshill Kombëtar të Shqiptarëve në Kosovë. Në vend të kësaj u formua Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare. Cila është arsyeja dhe pse u formua “qeveria e Kosovës” me një vonesë të tillë?

Qosja: Këshilli Koordinues i Partive Politike nuk u krijua si zëvendësim, dhe as nuk mund të jetë zëvendësim, për Këshillin Kombëtar Shqiptar. Këshillat koordinues janë një mbetje anakronike e vetëqeverisjes socialiste. Këto janë forumet që nuk mund të vendosin asgjë, dhe për këtë arsye nuk detyrojnë askënd të bëjë asgjë. Deri sa ekzistojnë Kuvendi dhe qeveria e Republikës së

Kosovës, Këshilli Koordinues i partive tona është një dështim politik. Unë personalisht mendoj se ne do të duhej të kishim krijuar Këshillin Kombëtar Shqiptar menjëherë pas shpërbërjes nga Serbia të Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv të Kosovës në korrik 1990. Nëse do ta kishin krijuar atë këshill, Serbia me siguri do të kishte më shumë punë për të bërë për shkak të Kosovës në Hagë sesa që në fakt kishte. Populli ynë thotë: nuk është kurrë vonë. Prandaj, unë shpresoj që ju nuk do ta vendosnit për kohë të gjatë në kllapa shprehjen “Qeveria e Kosovës”.

Cilat janë preokupimet dhe temat prioritare të intelektualëve dhe shkrimtarëve shqiptarë sot?

Qosja: Në kohën kur shqiptarët në Kosovë u privuan nga të gjitha burimet e tyre natyrore dhe atyre u mbeti vetëm ajri, kur të rinjtë tanë po na lkin në Evropën Perëndimore për të mos u zhdukur në luftën pushtuese serbe, kur shkollat dhe fakultetet tona u mbyllën, kur Akademia jonë e Shkencave dhe Arteve u shfuqizua, kur numri më i madh i familjeve nuk janë në gjendje t’i ushqejnë familjet e veta, kur fëmijët në vend që të lindin në maternitete, në shumicën e rasteve lindin në kushte të pamundura shëndetësore, kur qindra bashkëkombës arrestohen dhe maltrohen nëpër stacionet policore, kur na kërcënojnë me “knininxhat” e kapiten Draganit dhe kamat çetnike – në një kohë kur të gjitha hyrjet për në Kosovë përmes grykave të Ibrit, Rugovës dhe Kaçanikut janë të bllokua nga forcat policore dhe ushtarake, dhe kjo do të thotë në kohën e rrethimit në Kosovë, kur populli shqiptar është një popull i robëruar, preokupimet e intelektualëve, shkrimtarëve dhe krijuesve të tjerë shqiptarë nuk mund të jenë as letrare, as artistike, as shkencore. Preokupimi i tyre kryesor, nëse jo i vetmi, është fati i popullit shqiptar në Jugosllavi. Mund të them se mua po më preokupon shumë kriza politike, shoqërore dhe shpirtërore në Shqipëri. Sepse, pavarësisht kufirit të sotëm, ne jetojmë shpirtërisht dhe kulturalisht jetën e një kombi të bashkuar; i cili nuk ka pushuar kurrë së besuari se një ditë do të jetojë si një komb i bashkuar.

Krahas Ismail Kadaresë, ju jeni njëri prej intelektualëve më të shquar shqiptarë. Sa ndikon kjo që të keni kujdes në komunikimin tuaj me publikun?

Qosja: Statusi intelektual – që kam në jetën e popullit të cilit i përkas, sigurisht që më imponon detyrime që duhet t’i respektoj dhe që i respektoj në komunikimin me publikun. Populli im më rriti dhe puna e jeta ime u përkasin atij.

Çfarë jeni duke punuar për momentin?

Qosja: Përveç obligimeve të mia të përditshme, të cilat zakonisht i kam paradite, jam duke e përgatitur një libër mbi çështjen shqiptare, të cilin, nëse nuk do të kem pengesa shtesë, do ta përgatis deri nga mesi i vitit tjetër.

Marrë nga gazeta “Borba”, 12 dhe 13 dhjetor 1991.

Përzgjedhi dhe përktheu: Skënder Latifi

IN MEMORIAM: REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

Intelektuali që fliste në emër të popullit të plagosur

Telegramet e paraqitura këtu rrjedhin nga arkivat e deklasifikuara të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe hedhin dritë mbi një nga momentet më të rënda dhe më vendimtare të historisë sonë kombëtare: Konferencën e Rambujesë në shkurt 1999 dhe takimet e qershorit 1999 në Këln, në prag të çlirimit të Kosovës. Në secilin prej tyre, në mes të një dramaturgie diplomatike ku peshohej fati i një populli të tërë, qëndron figura e Rexhep Qosjes — i qetë, i matur, me peshën e shekujve mbi supe, dhe me zërin e një populli mbi gjuhë

Bejtullah Destani

Hyrje

Sot, në ditën kur zemra e kombit shqiptar ka rënë në heshtje të thellë për ndarjen nga jeta të akademikut Rexhep Qosja, po i paraqes para lexuesit këto dëshmi të çmuara arkivore me një mallëngjim që nuk mund të fshihet dhe me një nderim që fjalët vështirë se mund ta shprehin. Kur një burrë si Rexhep Qosja ikën, nuk ikën vetëm njeriu — ikën një epokë, ikën një zë që për më shumë se gjysmë shekulli foli aty ku shumë heshtën, ikën një ndërgjegje që nuk u përku kurrë para fuqisë së momentit, por u përku vetëm së vërtetës dhe popullit të vet.

Është detyrë e imja, dhe privilegj i rrallë, që në këtë orë dhimbjeje t'i ofroj kombit shqiptar një kujtim që nuk është ndërtuar mbi fjalë lavdërimi, por mbi burimin më të pastër që mund të flasë për një njeri: fjalën e vetë atij, të ruajtur në arkivat e historisë.

Dokumentet

Telegramet e paraqitura këtu rrjedhin nga arkivat e deklasifikuara të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe hedhin dritë mbi një nga momentet më të rënda dhe më vendimtare të historisë sonë kombëtare: Konferencën e Rambujesë në shkurt 1999 dhe takimet e qershorit 1999 në Këln, në prag të çlirimit të Kosovës. Në secilin prej tyre, në mes të një dramaturgie diplomatike ku peshohej fati i një populli të tërë, qëndron figura e Rexhep Qosjes — i qetë, i matur, me peshën e shekujve mbi supe, dhe me zërin e një populli mbi gjuhë.

Dy prej këtyre dokumenteve përbëjnë kopje plotësuese të të njëjtit telegram të Departamentit të Shtetit, që regjistron takimin e mëngjesit të 20 shkurtit 1999 mes sekretares së Shtetit, Madeleine K. Albright, Rexhep Qosjes dhe Veton Surroit, në Kështjellën e Rambujesë. Në atë takim, Qosja, me atë dinjitet të thellë që e karakterizonte, ia kujtoi sekretares se "Kosova vuan nga një marrëveshje e padrejtë e bërë 85 vjet më parë, e cila ka prodhuar cikle gjakderdhjesh, shkatërrimesh dhe masakrash", dhe kërkoi, me forcën e nje riut që e ka të qartë se po flet në emër të brezave, një garanci se populli i Kosovës do të mund ta shprehte vullnetin e tij përmes një referendumi. Prania e dy kopjeve të këtij telegrami në arkiv dëshmon rëndësinë që iu dha, qysh në momentin e parë, fjalës së tij.

Dokumenti i dytë regjistron mbledhjen ministrote të Grupit të Kontaktit të pasdites së po asaj dite, në të cilën Qosja — së bashku me Hashim Thaçin, Ibrahim Rugovën dhe Veton Surroit — artikuloi para ministrave të jashtëm të Francës, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Italisë, Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara qëndrimin unanimit të delegacionit kosovar se "qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të ligjshme të deklarohen lirshëm dhe në mënyrë demokratike për statusin e tyre". Në atë sallë, ku çdo fjalë peshohej në peshore të arta, Qosja e mbajti peshën e saj me nderin e një intelektualit që fliste në emër të një populli të plagosur.

Dokumenti i tretë, i datës 21 shkurt 1999, na sjell drekën e tendosur të punës, ku sekretarja Albright i kërkonte Kryesisë kosovare pranimin e marrëveshjes së ndërmjetme. Në atë moment të vështirë, kur presioni ndërkombëtar kërkonte nënshtrim, Qosja ngriti zërin për diçka më të lartë se një tekst: për natyrën e paqes që



Rexhep Qosja (djathtas), Idriz Ajeti dhe Bajram Kosumi, në Kështjellën e Rambouilletit, në perëndim të Parisit, më 21 shkurt 1999 (Foto: AP)

meritonte Kosova. Ai tha se paqja duhej të ishte një "paqe e drejtë" — një paqe që "do të qëndronte përgjithmonë". Në këto pak fjalë gjendet e gjithë filozofia e jetës së tij: se një popull nuk mund të pushojë me një paqe që nuk është e ndërtuar mbi drejtësi.

Dokumenti i pestë dhe i fundit, nga Këlni më 8 qershor 1999, në ditët kur qielli i Kosovës po pastrohej nga tymi i luftës, regjistron fjalët e Qosjes ndërsa e paraqiste luftën e popullit të tij si një përballje që i bëhej bashkësisë ndërkombëtare për të mbrojtur "vlerat e qytetërimit bashkëkohor, si demokracia dhe të drejtat e njeriut". Atje, me atë largpamësi që rrallëherë të vendoste për statusin e tij politik, dhe paralajmëroi me dhimbje për dualitetin "absurd dhe të patolerueshëm" të institucioneve paralele, duke e kuptuar se përçarja e brendshme ishte rreziku më i madh që na kanosej pas çlirimit.

Kujtesa historike

Të lexuara së bashku, këto dokumente nuk janë thjesht letra të arkivuara — ato janë zë. Janë zëri i një burri që, në orët më të vështira të popullit të tij, nuk u lëkund, nuk u përku, nuk e tregtoi të vërtetën për lehtësinë e momentit. Rexhep Qosja shkoi në Rambuje jo si politikan që kërkonte pozitë, por si intelektual që mbante mbi shpatulla peshën e një historie të gjatë padrejtësisësh. Ai foli me gjuhën e drejtësisë kur të tjerët flisnin gjuhën e kompromisit. Ai kujtoi të kaluarën kur të tjerët donin ta harronin. Ai përmendi popullin kur në sallat e mëdha flitej vetëm për shtete.

Dhe pikërisht për këtë — sot, kur ai nuk është më — këto fjalë të tij, të ruajtura në gjuhën e ftohtë diplomatike të një fuqie të huaj, do të mbeten të

ngrohta në zemrën e kombit tonë. Sepse kombet nuk i kujtojnë burrat e tyre nga titujt që kanë mbajtur, por nga betejat që kanë luftuar për ta, dhe nga fjalët që kanë thënë kur askush tjetër nuk guxonte t'i thoshte.

Shënim mbi botimin

Këto dokumente janë riprodhuar nga deklasifikimi zyrtar i autorizuar nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Rasti Nr. M-2017-11760 dhe Rasti Nr. M-2017-11766, të lëshuara më 18 maj 2018). Ato botohen sot, në ditën e ndarjes së përjetshme nga profesor Rexhep Qosja, si homazh i përvuajtur i një shërbëtori të përvuajtur të kauzës shqiptare ndaj një burri që ishte, për kombin tonë, një nga kolosët e fundit të një brezi që nuk do të përsëritet.

Lamtumirë, akademik i nderuar!
E paçim kujtimin të pavdekshëm, ashtu si të pavdekshme janë fjalët që na i le trashëgim — në arkiv, në komb, dhe në çështjen e përjetshme të një paqeje të drejtë për Kosovën.

Qosja: Vlerat e qytetërimit bashkëkohor në rrezik në Kosovë

Konfidenciale ptq 5456
• Sekretarja e Shtetit, Madeleine K. Albright
• Amb. Jim Dobbins, Këshilltar Special i Presidentit dhe Sekretares për Kosovën dhe Zbatimin e Dejtonit
• Zëvendëssekretar për Çështjet Publike, James Rubin
• Shefja e Kabinetit, Elaine Shocas
• EUR/DAS, Jim Swigert
• Drejtori i EUR/SCE, Larry Rossin
• Përkthyesi
• Guillermo Christensen, Am-

basada e Bonit (mbajtës shënimesh)

LIDERSHIPI SHQIPTAR I KOSOVËS:

- Dr. Ibrahim Rugova, President, Partia LDK
- Dr. Rexhep Qosja, President, Partia LBD
- Hashim Thaçi, Përfaqësues Politik, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)
- Adnan Merovci, ndihmës i Rugovës
- Ismi Beshiri, ndihmës i Qosjes
- Sherif Bilali, ndihmës i Thaçit

8. (C) Duke folur, siç duket, në emër të të treve, Qosja e quajti përpjekjen në Kosovë si sfidë për komunitetin ndërkombëtar për të mbrojtur vlerat e qytetërimit bashkëkohor, si demokracia dhe të drejtat e njeriut. Në këtë drejtim, kosovarët besonin në përcaktimin e një vizioni për Kosovën që parashikonte triumfin e demokracisë mbi diktaturën. Duke kaluar te specifikat e diskutimeve të fundit që rridhnin nga G-8, Qosja ngriti shqetësimet për dispozitat në tekstin Chernomyrdin-Ahtisaari — veçanërisht për vendndodhjen e forcave ruse në Kosovë dhe numrin e forcave serbe që do të lejoheshin të ktheheshin në Kosovë. Qosja shprehu shqetësim të veçantë se forcat serbe, edhe nëse do të ishin të pranishme në numër më të vogël sesa parashikohej në Rambuje, do të mund ta përdornin praninë e tyre në Kosovë për të luajtur rolin e "kalit të Trojës". Në dritën e kësaj, Qosja shpresonte që kohëzgjatja e vendosjes së NATO-s të zgjatej. Një tjetër shqetësim kyç i kosovarëve lidhur me dokumentin Chernomyrdin-Ahtisaari ishte mungesa e një afati kohor për një konferencë që do të vendoste për çështjet e statusit final. Fushata ushtarake, sipas Qosjes, do të kishte qenë vërtet e suksesshme kur populli i Kosovës të kishte pasur mundësinë të vendoste statusin e tij

politik brenda 3-5 viteve të ardhshme. 9. (C) Gjatë takimit të përbashkët dhe një takimi të veçantë pasues dy-palësh me Sekretaren, Qosja iu kthye çështjes së mungesës së unitetit në lidhshin kosovar: Qosja shprehu shqetësimin se mungesa e unitetit ishte më serioze dhe më e rrezikshme sesa dukej dhe e vendoste popullin e Kosovës në një pozitë shumë të vështirë në një moment kritik. Duke e quajtur dualitetin e institucioneve të "qeverisë së Kosovës" si "absurd dhe të patolerueshëm", Qosja parashikoi se këto ndarje do të shkaktonin probleme më të mëdha pasi dy grupet e lidhshin dhe përkrahësit e tyre të armatosur të ktheheshin në Kosovë. Qosja iu lut Sekretares për ndihmën e saj në zgjidhjen e këtij problemi dhe iu referua pozitivisht propozimit të saj për një strukturë Këshilli Kombëtar i Sigurisë që të shërbente si mekanizëm i ndërmjetëm në pritje të zgjedhjeve. Ai gjithashtu paralajmëroi për lidhje negative midis ndarjeve politike kosovare dhe rivaliteteve të ashpra në Shqipëri, të cilat gjithnjë e më shumë ushqenin njëra-tjetrën dhe duhej të trajtoheshin si një e tërë. Qosja mbështeti nevojën për të injektuar përmbajtje në qëndrimet e kosovarëve sapo të fillonte kthimi. Në këtë drejtim, puna e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë do të ishte kritike për rindërtimin e marrëdhënieve paqësore mes grupeve të ndryshme etnike.

Garanci për një referendim për Kosovën

E PAKLASIFIKUAR
Departamenti i Shtetit i SHBA-së
Rasti Nr. M-2017-11760 |
Dokumenti Nr. C06550506 |
Data: 18/05/2018
SUBJEKTI: TAKIMI I

SEKRETARES ME LIDERËT E DELEGACIONIT SHQIPTAR TË KOSOVËS, QOSJA DHE SURROI, 20 SHKURT 1999

1) (U) KLASIFIKUAR NGA ZËVENDËS-SEKRETARI EKZEKUTIV STEPHEN MULL, ARSYET 1.5 (B) DHE (D).

2) (U) 20 SHKURT 1999, ORA 09:25, KASTELLI I RAMBUJESË, FRANCË.

3) PJESËMARRËSIT: PALA AMERIKANE:

- Sekretarja [Albright]
- Ambasadori Christopher Hill
- Kirsten Schulz, Ambasada Amerikane në Oslo, POI-OFF (mbajtëse shënimesh)
- Përkthyes (shqip)

PALA SHQIPTARE E KOSOVËS:
• Rexhep Qosja, Kryetar i Frontit të Bashkuar Demokratik (LBD)
• Veton Surroi, botues i "Koha Ditore"

4. (C) PËRMBLEDHJE:

Sekretarja u bëri thirrje shqiptarëve të Kosovës ta nënshkruanin marrëveshjen kornizë të përkohshme. Qosja tha se ndihet i pakëndshëm me tekstin dhe kërkoi një garanci për një referendum për Kosovën në fund të periudhës së përkohshme trevjeçare. Ambasadori Hill tha se kishte pranuar ndryshime nga delegacioni shqiptar i Kosovës gjatë natës së 19 shkurtit dhe shtoi se çdo dallim i mbetur mund të trajtohej më vonë.

Autoriteti i Rishikimit: Marvin Russell, Rishikues i Lartë

Sekretarja nënvizoi rëndësinë taktike të pajtimit të shqiptarëve të Kosovës me marrëveshjen e plotë kornizë. Ajo dëshironte ta çonte marrëveshjen e tyre të serbët, në mënyrë që, nëse do të kishte dështim në arritjen e një marrëveshjeje të përgjithshme, një palë të mund të mbahej përgjegjëse. Nëse shqiptarët e Kosovës nuk pranonin në parim tekstin ekzistues, situata do të bëhej e ndërlikuar dhe bashkësia ndërkombëtare nuk do të mund të ndihmonte. Koha ishte thelbësore. Sekretarja ofroi të takohej me të gjithë delegacionin shqiptar të Kosovës brenda një ore, por u përsëriti Qosjes dhe Surroit nevojën për të arritur marrëveshje për arsye taktike. **FUND I PËRMBLEDHJES.**

Lavdërime për delegacionin shqiptar të Kosovës

1) (C) Sekretarja i tha Qosjes dhe Surroit se po ndodheshim në momentet e fundit të negociatave. Ajo ishte e kënaqur me punën që delegacioni shqiptar kishte investuar në konferencë dhe në trajtimin e tekstit. Kishte pasur prej atyre që mendonin se nuk do të kishte marrëveshje dhe se dështimi do t'u atribuohet shqiptarëve të Kosovës. Por, nëse ka shpresë për sukses, është sepse shqiptarët e Kosovës kanë bërë shumë punë të detajuara.

Sekretarja u bëri thirrje shqiptarëve të Kosovës të pranojnë tekstin aktual

2) (C) Por, për të ecur përpara, Sekretarja i nevojiteshin sigurime nga pala shqiptare e Kosovës se ajo pronte marrëveshjen politike dhe anekset e saj ushtarake dhe policore. Ajo do t'i çonte sigurimet e tyre të serbët dhe do t'u thoshte atyre se shqiptarët e kishin pranuar marrëveshjen kornizë. Kështu, nëse konferenca do të dështonte, do të ishte e qartë se serbët ishin pala që kishte refuzuar të pajtohej. Sipas rregullave të vendosura diplomatike, asgjë nuk është e pranuar nëse nuk është pranuar gjithçka. Nëse serbët nuk do të pajtoheshin, shqiptarët e Kosovës nuk do të ngeceshin në qëndrimin e tyre. Ne do të vendosnim se çfarë të bënim nëse serbët dështonin të pajtoheshin. Shqiptarët e Kosovës nuk do të bllokoheshin.

1) (C) Sekretarja u tha Qosjes dhe Surroit se negociatorët kishin punuar tërë natën për marrëveshjen politike dhe se ajo kishte kuptuar nga Ambasadori Hill se pjesa më e madhe e asaj që shqiptarëve të Kosovës nuk u pëlqente në tekst ishte hequr. Ambasadori Hill tha se mund të gjendej kompromis për çdo dallim të mbetur. Sekretarja përsëriti kërkesën e saj që shqiptarët e Kosovës t'i thoshin asaj se kishin rënë dakord për tekstin, në mënyrë që ajo të mund t'u thoshte serbëve: "Shqiptarët e Kosovës kanë rënë dakord".

Qosja kërkon garanci për një referendum

2) (C) Qosja tha se ai nuk ishte i sigurt për përmbytjen e tekstit aktual të marrëveshjes. Delegacioni i tij kishte punuar nga një tekst i paraqitur më 6 shkurt, dhe më pas i ishte paraqitur një tekst i [datës së mëvonshme të] shkurtit. Teksti i dytë kishte qenë zhgënjim për delegacionin, i cili ishte i shqetësuar se mund të arrihej një "marrëveshje e padrejtë". Kosova vuan nga një marrëveshje e padrejtë e bërë 85 vjet më parë, e cila ka rezultuar në cikle gjakderdhjeje, dëmtim pronash dhe masakra. Një nga këto cikle sapo ishte përjetuar. Sekretarja i tha Qosjes se teksti për të cilin ajo po i kërkonte të pajtohej ishte i ri dhe se Ambasadori Hill kishte marrë parasysh shqetësimet e shqiptarëve të Kosovës.

Qosja tha se kishte një shqetësim qendror. Ai e dinte se paqja mund të garantohej tani nga prania e forcave të NATO-s, siç e kishin parashikuar SHBA-të. Megjithatë, ai ishte i shqetësuar se çfarë do të ndodhte pas tre vitesh. Ai donte një garanci, një premtim, se populli i Kosovës do të mund ta shprehte mendimin e tij përmes një referendumi. Referendumi ishte një "institucion demokratik" dhe Qosja e dinte se shqiptarët e Kosovës kishin të drejtë për një të tillë. Këtu do të përcaktohej drejtësia. SHBA-të ishin një

fuqi e madhe ekonomike, por ishin edhe fuqia më e madhe morale në botë. Qosja e mbylli me një thirrje që SHBA-të të ndihmonin në arritjen e paqes.

Amb. Hill thotë se dallimet e mbetura mund të zgjidhen

9. (C) Ambasadori Hill i tha Qosjes se delegacioni shqiptar i Kosovës kishte prodhuar gjuhë të re mbrëmjen e 19 shkurtit. Sipas mendimit të avokatëve të tij, kjo gjuhë mund të përfshihet dhe të bëhet e pranueshme për palën tjetër. Kjo çështje mund të zgjidhet. Por na duhet një taktikë për atë ditë për të përballuar palën serbe. Do të kishte çështje që shqiptarët e Kosovës do të kishin nevojë të zgjidheshin në kënaqësinë e tyre. Ato do të zgjidheshin. Për shembull, shqiptarëve të Kosovës nuk u kishte pëlqyer koncepti i një dhome të dytë në parlament; tani nuk do të kishte një dhomë të tillë. Ne do të punonim për çështjet e mbetura për kënaqësinë e ndërsjellë të palëve. Por na duhet presion maksimal mbi serbët.

Sekretarja përshkruan tre skenarë, u bëri thirrje për marrëveshje

10. (C) Sekretarja tha se ajo nuk donte ta përfundonte ditën me një situatë që ishte e paqartë se "kush kishte rënë dakord për çfarë". Situata më e mirë ishte ajo në të cilën të gjitha palët kishin rënë dakord për të gjithë tekstin e marrëveshjes kornizë. Në situatën e dytë më të mirë, shqiptarët e Kosovës do të kishin rënë dakord dhe serbët do të kishin mospajtuar. Situata më e keqe do të ishte ajo në të cilën serbët nuk do të kishin rënë dakord dhe shqiptarët e Kosovës do të ishin të ndarë. Sekretarja u kërkonte shqiptarëve të Kosovës "të pajtoheshin tani", në mënyrë që ajo të mund t'u thoshte serbëve: "Shqiptarët e Kosovës pajtohen; është në duart tuaja".

Qosja dhe Surroi kërkojnë kohë për t'u konsultuar

11. (C) Qosja tha se do të duhej të fliste me të gjithë delegacionin shqiptar të Kosovës. Sekretarja e kuptoi. Ajo pyeti Qosjen: "A i kuptoni taktikat?" Qosja tha se po. Surroi tha se mbështeste konceptin e draftit të 6 shkurtit dhe se delegacioni do të punonte për të arritur marrëveshje në orën e ardhshme. Sekretarja tha se nuk kishte shumë kohë, por ofroi të takohej me të gjithë delegacionin shqiptar të Kosovës.

ALBRIGHT
KONFIDENCIALE
FUND I DOKUMENTIT

Pjesë të shkëputura nga arkivat e deklasifikuara të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, publikuar nga Bejtullah Destani

© KOHA Ditore

REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

“Ky libër na ra nga qielli si një meteorit”

Disa shkrime frëngjisht për romanin “Vdekja më vjen prej syve të tillë”

Duke mos i pasur gazetën e revistat franceze, po botojmë këtu një vështrim të përmblodhur të lingvistit shqiptar, Remzi Përnaska, për disa shkrime të autorëve francezë mbi romanin e botuar nga “Gallimard” më 1994, “Vdekja më vjen prej syve të tillë”.

Kritikja letrare franceze, Nicole Zand, në “Le Monde des Livres” shkruan: “Autori i këtij romani është

një profesor i shquar i letërsisë së krahasuar në Universitetin e Prishtinës, por edhe një eseist, një autor dramatik, një polemist, një nga intelektualët e shkëlqyer dhe trazues të Kosovës... Ky libër na ra nga qielli si një meteorit. Një objekt letrar jo i zakonshëm... Një tregim i fortë dhe i bukur dhe i futurë, i quditshëm dhe shpërfillës... një herazi i fabul politik dhe fresk i

një komuniteti primitiv... larg shtigjesh të rrahura, sa për ana letrare aq edhe gjeografike... Autori di të përdorë penën e vet si thikë... Ajo që bie në sy të Rexhep Qosja është origjinaliteti i madh, liria, sa në ndërtim aq edhe në gjuhë”.

Catherine Argand, në revistën “Lire”, përpos të tjerash, shkruan: “Për këtë shqiptar të ekziluar në Kosovë dimë shumë pak gjëra... është e pamundur të dihet më shumë. Ky zotëri i lindur më 1936 në gjirin e një populli të ndaluar, tani nuk mund të takohet për shkak të luftës”.

Frédéric Vitoux, në revistën “Nuvel Observator”, përpos të tjerash, shkruan:

“Një zbulim i vërtetë, ky shkrimtar është i madh... Si ta cilësojmë këtë roman?... është e pamundur që të cilësohet, i shpëton çdo cilësimi ose, që është e njëjta gjë, është i shumëfishshëm... Tregimi i mrekullueshëm, gjithandej, fantazi filozofike, kronikë për malluese e një qyteti të vogël të Kosovës... Shkurt, lirik, kërcëllitës, fantastik, realist, humorist, qesëndisës, i pamëshirshëm dhe ndoshta në fund të fundit, me një dhembshuri të pafund për të gjitha këto personazhe, madje edhe për të poshtrit... Qosja ka shumëzuar në 13 herë ose në 13 'tregime' rrugët dhe zërat që të na tërheqë në vendin e vet, në kujtesën e vet, në vuajtjen dhe në vitalitetin e vet”.

Revista “Glamurx” e marsit të vitit 1994: “Lexuesi e di se makthi është real, që marria larg së qeni trashëgimi, është pjellë e jetës së përditshme – është mesazhi i këtij romani, të kësaj pasqyre të thyer”.

André Clavel shkruan: “Vepra profetike nuk pushon së parathëni katastrofën që godet Ballkanin” e revista “Construire”: “Një roman tragjikokomik”.

Gazeta “La Montagn”: “Një roman i madh, në kuptimin letrar, shumë militant, njëzet vjet pas botimit për herë të parë... Ai (autori) i jepet një ushtrimi të shkëlqyer ku gërshehohen të gjitha gjinitë për të mbrojtur çështjen e popullit të vet”.

K. Argant e krahason autorin me Havellin: “Njeriu është tokë e panjohur” shkruan Qosja, të cilit njëherazi, me romanin, i zbulojmë talentin. Na mbetet nga ky Kafka në lindje një roman që të lë pa mend, që zhyt të tërin, artin e shqetësimin, në ujën e

tallazuar të Jugut. Tamam sikur kapela gri e Pragasi të bëhej blu në Kosovë... I shkruar më 1974, romani “Vdekja më vjen prej syve të tillë” përzieni sarkazmat e fabulës politike me arabeska të tregimit oriental në një qytet të vogël të Kosovës mbushur më Tartufë e Juda, një shkrimtar shqiptar – Zhezaire Gjika – përpigjet të ruajtjeje dinjitetin e vet duke i shpëtuar mallkimit të një diktature të dyfishtë,

asaj të Titos dhe asaj të Enver Hoxhës. Meqë nuk pranon të nënshtrohet, policia e fut në burg dhe përfiton dhe e tradhton... Pra, kemi tradhti në të gjitha format e saj, dashurorë ose politike, që ky roman fshikullon me afsh verbues, hakmarrës, të denjë për një Volter të humbur në Ballkan, në këtë fuqi baruti”.

Elisabet Champseix: “Regjistri ndryshon nga


tregimi te e vërteta populiste, nga rrëfimi te satira politike duke kaluar nëpër shkatërrimin e tregimit... Nuk është fjala për një roman të thjeshtë denoncimi politik... Vizioni i Rexhep Qosjes nuk është manekin: nuk ka nga njëra anë serbë të këqinj dhe nga tjetra shqiptarë të mirë. Të keqen e kemi brenda. Brenda për shqiptarët apo për mbarë njerëzimin”.

Shtypi francez thotë në fund të përmblodhjes së tij të shkrimeve të të përditshmeve, javoreve, dyjavoreve, mujoreve dhe revistave franceze, për romanin “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, lingvisti që jeton në Paris, Remzi Përnaska, nuk mungoi në të gjitha rastet që të theksojë se albanologu francez, Christian Gut, ka bërë një përkthim mjeshtër të këtij romani.

Prof. Dr. Daniel Leuwers: “Mënjëherë pas botimit të romanit ‘Vdekja më vjen prej syve të tillë’, kritikët e kanë vlerësuar këtë vepër si një thurje mjeshtërore dhe të mprehtë si theu i thikës. Qosja prenë, nuk heziton të përgjaketë plagët. Ironia e tij është e fortë, e largon negativitetin. Ai është krahasuar me Vaslav Havelin e madje edhe me Volterin. Për mendimin tim, unë do ta vendosja afër Balzakut dhe vepërës së tij ‘Skena e jetës në provincë’, në të cilën janë të dukshme të gjitha anët e ‘komedisë njerëzore’. Analizë precize, që i ndjek dhe i përcjell Tartufët dhe të gjithë Judët, ndërsa e përdor ironinë dhe formën e Milan Kunderës. Njeriu është ai që luan me forcën dhe që i tejkalon dhe thyen ideologjitë dhe religjionet. Në këtë tragjikomedi, në vazhdim, kemi përshtypjen që Sizifi (Sizifi nga Albert Kamy) lufton me qesharaken dhe harresën, kundër të gjitha kontradiktave njerëzore. Mirëpo, Rexhep Qosja shkon edhe më larg: ai e demistifikon imazhin e shkrimtarit, i cili i ka të gjitha të metat si çdo njeri tjetër, bile edhe dembelinë, oportunizmin dhe propagandën e tij politike. Jo, për Qosjen, shkrimtari i vërtetë nuk përfiton asgjë. Shkrimtari është i rrjepur dhe i nëmur. Ndërkaq, ne, duhet t'i ruhem përjetësisë, sepse ajo krijon mite të rrejshme, duke e panguar instinktin tonë të domosdoshëm të kritikës.

Shkëputur nga teksti i prof. dr. Isak Shema

© KOHA Ditore



Rexhep Qosja në Paris, shkurt 1999 (Foto: AFP)

IN MEMORIAM: REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

Rexhep Qosja në sytë e Shqipërisë së viteve 1968-1990

Veprimtaria e profesor Rexhep Qosjes gjatë viteve 1968-1990, në dritën e disa dokumenteve arkivore të shtetit shqiptar, mund të “lexohet” nga këndvështrime të ndryshme. Por qysh më 1968 ai ra në sy me kumtesën në Simpoziumin për Skënderbeun. Në një dokument të vitit 1970, për të shkruhej se “është një kritik me talent dhe një punonjës i zellshëm në fushën e studimeve historiko-letrare. Ai ka një horizont të gjerë letrar dhe premtion për punë ngulmonjëse e serioze në lëmin e studimeve të letërsisë shqiptare”. Në fund të atij viti, pas një vizite të delegacionit nga Shqipëria në Prishtinë, në një relacion shkruhej se “fjalimi i Qosjes nuk qe dhe aq në nivel, në krahasim me aftësitë e tij, po jo keq”, duke vazhduar se “ky është ndër njerëzit më me kulturë që kanë... ende fort i ri”

Nuridin Ahmeti

Simpoziumi për Skënderbeun më 1968

Në maj të vitin 1968, në Prishtinë organizohet Simpoziumi shkencor për nder të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Siç është tanimë e njohur, ky organizim tuboi studiues nga ish-Jugosllavia, Tirana dhe albanologë të huaj. Në mesin e studiuesve që do të paraqiteshin me kumtesa në këtë organizim, ishte edhe Profesor Rexhep Qosja, me kumtesën: “Skënderbeu në vizionin poetik të Naim Frashërit”. Shtypi, asokohe shkruante për paraqitjen me kumtesë në këtë organizim të Profesor Rexhep Qosjes. Një pesë e kumtesës së paraqitur në këtë organizim nga profesor Qosja, u botua të nesërmen në shtyp. Në lidhje me këtë, studiuesit nga Tirana, pjesëmarrës në këtë organizim, me rastin e kthimit të tyre në Tiranë, kishin përgatitur për institucionet përkatëse të Tiranës një raport, të titulluar: “Mbi vizitën e grupit të punonjësve shkencorë të Universitetit Shtetëror të Tiranës në Kosovë me rastin e Simpoziut kushtuar Skënderbeut”. Ata kishin shënuar se gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, atyre iu bë “në përgjithësi një pritje zyrtare korrekte” nga ata të cilët ishin ftuar, pra “nga drejtuesit e Institutit Albanologjik dhe nga bashkësia e shkollave të larta në Prishtinë”.

Në pjesën e këtij raporti, ku shkruan për kumtesat dhe referatet e mbajtura në këtë organizim nga studiuesit shqiptarë në ish-Jugosllavi, ata theksojnë: “Përgjithësisht mund të thuhet se kumtesat e mbajtura nga shqiptarët vendas ishin në një nivel shkencor mjaft të ulët; ato i përshkonte përgjithësisht fryma patriotike por metodologjikisht ishin të dobëta dhe nuk sillnin ndonjë rezultat shkencor për t'u shënuar”. Për Profesor Ali Hadrin, ata kishin bindjen, si ai ishte “njeriu i mbështetur nga regjimi titist”, ndërsa për referatin e mbajtur nga ai, ata e vlerësojnë si një referat “në një nivel shkencor të ulët, më tepër një ritregim faktesh, pa ndonjë material dhe koncept të ri të vetin”.

Mirëpo, sipas përgatitësve të raportit “nga kumtesat me të mira mund të konsiderohet ajo e Rexhep Qosjes me titull: ‘Skënderbeu në vizionin poetik të Naim Frashërit’ që binte në sy për trajtimin e thellë e të drejtë të temës, për kulturën e gjerë të autorit”. Profesor Qosja, nga ky moment, do të jetë ndër me të përmendur në relacione e informacione të përgatitura në Tiranë, kryesisht, për punën e vyer të tij në drejtim të letërsisë shqipe dhe kritikës letrare. Janë disa studiues nga Kosova që vlerësohen nga studiuesit e Tiranës për paraqitjet e tyre në këtë organizim, por Profesor Qosja dhe paraqitja e tij, kishte lënë mbresa të theksuara tek ata.

Dokumenti i vitit 1970: “Një kritik me talent dhe një punonjës i zellshëm”

Viti 1970 është i begatshëm sa i përket dokumentacionit që lidhet me personalitetin e Profesor Rexhep Qosjes, sepse gjatë këtij viti Profesori do ta vizitonte Shqipërinë dhe sigurisht se ka prodhuar material edhe për përgatitësit e relacioneve. Prej datës 6 deri më 28 janar 1970 Profesor Qosja qëndron në Tiranë si i ftuar nga Universiteti Shtetëror i



Rexhep Qosja dhe Dritëro Agolli më 1972 në Tiranë

Tiranës. Gjatë kësaj kohe, Profesor Qosja kishte hulumtuar dhe mbledhur materiale për punimin e tij të disertacionit “Asdreni: jeta dhe krijimtaria letrare”. Më 6 shkurt të vitit 1970, sipas kërkesës së Behar Shtyllës, studiuesi Androkli Kostallari i dërgon relacion në lidhje me qëndrimin e Profesor Qosjes në Tiranë dhe një informacion në lidhje me gjendjen e letërsisë shqipe në Kosovë sipas mendimeve të Profesor Qosjes. Sipas, këtij relacioni, Profesor Rexhep Qosja “është një kritik me talent dhe një punonjës i zellshëm në fushën e studimeve historiko-letrare. Ai ka një horizont të gjerë letrar dhe premtion për punë ngulmonjëse e serioze në lëmin e studimeve të letërsisë shqiptare”, shkruan në mes tjerash në këtë relacion.

Sipas relacionit të përgatitur, Profesor Qosja vlerëson përparimet e mëdha të Shqipërisë “në lëmin ekonomik e kulturor; atij i ka bërë përshtypje të veçantë fakti që në Shqipëri ka ndryshuar dhe fizionomia e njeriut, është formuar një njeri i ri, me tipare të reja”, shkruhet në mes tjerash në këtë relacion. Ndërsa sa i përket aspektit fetar në Shqipëri, sipas relacionit Profesor Qosja, faktin e ateizimit të Shtetit shqiptar e sheh si domethënëse “që Shqipëria është vendi

i parë në botë pa kisha e pa xhami”, shkruan në mes tjerash në relacion.

Ndërsa, sa i përket relacionit në lidhje me gjendjen e letërsisë shqipe në Kosovë, në relacion shënohen mendimet e Profesor Rexhep Qosjes për letërsinë në përgjithësi, romanin, prozën, poezinë, letërsinë për fëmijë etj., duke veçuar edhe emra të veçantë si: Hivzi Sylejmani, Esad Mekuli, Enver Gjergjku etj. Bie fjala, për Esad Mekulin, në relacion shënohet ky mendim i Profesor Qosjes se “pikënisje e frymëzimit të tij është po ai fshatar, po ai njeri që herë i thonë shqiptar, herë shiftar, herë lypës e herë sharraxhi. Si poet E. Mekuli ndien thellë në shpirt imperativin e lirisë dhe krijon kultin e saj. Plagë e veçantë, e pashëruar ende, është plaga e kurbetit. Këtë temë e ka trajtuar me forcë të rrallë”, shkruan në mes tjerash në këtë relacion.

Në vitin 1970, në Tiranë përgatitet një informacion lidhur me studiuesit e dalluar të Kosovës në fushën e albanologjisë. Në këtë informacion, ofrohet nga një rezumë e shkurtër për studiuesit: Idriz Ajeti, Ali Hadri, Mark Krasniqi, Syrja Pupovci, Femi Agani, Hajredin Hoxha, Hasan Kaleshi, Rexhep Qosja, Zekeria Cana, Skender Rizaj, Ahmet Kelmendi, Ismet Dërmaku, Latif Mu-

laku, Anton Çetta, Isak Shema, Halit Tërnafici, Ramiz Kelmendi, Shefqet Pllana e Olivera Jashari-Nasteva. Për Profesor Rexhep Qosjen, ata shkruajnë me nota pozitive, duke shënuar këtë vlerësim: “Kritik letrar, historian i letërsisë shqipe; shef i sektorit të historisë së letërsisë në Institutin Albanologjik, pedagog në fakultetin përkatës. Ka një përgatitje serioze shkencore me mendime pozitive, është prodhues aktiv, autor i një varg librash e studimesh, në të cilat përpiqet për një kuptim ideologjik të drejtë të fenomeneve të historisë së letërsisë shqipe dhe ngul këmbë për të ndjekur vijën drejtuese të shkencës sonë albanologjike. Ishte në vendin tonë për studime kohë më parë dhe mban qëndrim shumë të mirë ndaj nesh”, shkruan në këtë informacion.

“Ky është ndër njerëzit më me kulturë që kanë... ende fort i ri”

Në fund të vitit 1970, në Prishtinë, Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, kishte organizuar një akademi përkujtimore me rastin e 70-vjetorit të vdekjes së Naim Frashërit. Delegacioni nga Tirana ishte i përberë nga Dhimitër S. Shuteriqi, në cilës-

inë e kryetarit, Zija Xholi dhe kompozitori Tish Daija. Ky delegacion, në Prishtinë kishte ardhur përmes Strugës dhe në kufij ishte pritë nga Mark Krasniqi, në cilësinë e Kryetarit të shoqatës, profesor në Universitetin e Prishtinës dhe shkrimtar; Vehap Shita, Sekretar i Shoqatës, redaktor i gazetës “Rilindja”, kritik letrar, Azem Shkreli, anëtar i kryesisë së shoqatës, Drejtor i Teatrit të Prishtinës, shkrimtar, Maksut Shehu, anëtar i kryesisë së shoqatës dhe shkrimtar. Në relacionin e dërguar në institucionet përkatëse në Tiranë, ata shënojnë se organizimi i kësaj akademie përkujtimore u mbajt në Teatrin Krahinor të Prishtinës, siç quhej asokohe dhe fjalën e rastit e mbajti kritik letrar Rexhep Qosja, por për fjalën e tij ata shtojnë se “fjalimi i Qosjes nuk qe dhe aq në nivel, në krahasim me aftësitë e tij, po jo keq”. Në të njëjtin relacion, në disa faqe me poshtë, kur flasin për Profesor Qosjen, ata shkruajnë: “Ky është ndër njerëzit më me kulturë që kanë, talent i veçantë për kritikën dhe historinë letrare, punëtor i madh, ende fort i ri (më pak se 35 vjeç). Të gjithë e paraqesin si njeri shumë të ndershëm dhe i tillë na u duk. Ka admirim të madh për punën që bëhet te ne, po në shkrimet e tij nuk mungon, në mënyrën e vet, një farë polemizimi me kritikën dhe historiografinë tonë letrare”.

“E para mbrojtje e disertacionit në gjuhën shqipe në Jugosllavi”

Më 20 mars, të vitit 1971 Rexhep Qosja, në amfiteatrin e madh të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, mbron temën e disertacionit “Asdreni: jeta dhe krijimtaria letrare”, para komisionit të përbërë nga profesorët: Idriz Ajeti, Aleks Buda, Androkli Kostallari, Jashar Rexhepagiqi dhe Ali Hadri. Të nesërmen, më 21 mars shtypi, përmes gazetarit të atëhershëm, shkrimtarit të njohur, Musa Ramadani shkruante: “Rexhep Qosja – doktor i shkencave filologjike” dhe “kjo ishte e para mbrojtje e disertacionit në gjuhën shqipe në Jugosllavi”. Në lidhje me këtë, dy studiuesit e njohur nga Tirana, Profesorët Buda dhe Kostallari, në informacionin e tyre, të përgatitur për këtë ngjarje, shënuan, se ishte ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme, manifestim i fuqishëm si në aspektin patriotik dhe atë politik, një atmosferë ndoshta e paparë deri në atë kohë dhe i vlerësonin jashtëzakonisht, falënderimet për institucionet e Tiranës që Profesorët Qosja dhe Ajeti, i kishin potencuar vazhdimisht gjatë ceremonisë së mbrojtjes së disertacionit.

Përdërisa në vitin 1971, kemi vlerësime pozitive për figurën e Profesor Rexhep Qosjes nga Tirana, gjatë hulumtimeve, kemi hasur edhe dokumentacione, me mendimet të studiuesve nga Kosova për kolegët e tyre, që në shumicën e rasteve janë përshkrime emocionale. Bie fjala, në një informacion sekret të vitit 1971, shënojnë disa mendimet të Ali Aliut, Vehap Shitës, Ali Podrimjes e Esat Mekulit, të shprehura gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri për letërsinë në Kosovë, e rrjedhimisht edhe për disa shkrimtarë e studiues të kësaj fushë. Profesor Ali Aliu, është studiuesi që flet me tone pezhorative në lidhje me figurën e Rexhep Qosjes. “Njerëzit nga Kosova dhe sidomos inteligenca”, thoshte Ali Aliu, “kanë nevojë të vijin në Shqipëri për të pastruar

IN MEMORIAM: REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

Antologjitë e letërsisë shqipe të Rexhep Qosjes

Akademik Rexhep Qosja është personalitet poliedrik i studimeve letrare me famë kombëtare dhe ndërkombëtare. Opusi i veprave të tij është i gjerë dhe ka vlerë të madhe, duke u përfshirë kështu në thesarin e trashëgimisë e çmuar të artit letrar, të shkencës së letërsisë, të mendimit shqiptar të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar dhe të fillimit shekullit të ri. Shquhet posaçërisht me veprimtarinë universitare, me krijimtarinë letrare (autor i romaneve dhe dramave), si studiues i mirëfilltë i shkencave filologjike, është historian i letërsisë, kritik letrar, publicist

Isak Shema

Me Rexhepin jemi bashkë plot shtatëdhjetë vjet. Në vitin 1954 jemi regjistruar në Shkollën Normale të Prishtinës dhe jemi diplomuar në vitin 1959. Në vitin 1960 jemi regjistruar në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe, ndërsa diplomën universitare e kemi marrë në vitin 1964. Kemi studiuar në shkollën e tretë të studimeve magjistraturës në vitin 1968. Ai është pranuar në punë në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ndërsa unë asistent në Fakultetin Filozofik, në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe. Kemi qenë profesorë të Universitetit të Prishtinës dhe së bashku kemi përgatitur shumë breza të studentëve dhe të albanologëve të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare. Vepra e tij letrare dhe shkencore ka zënë vend të merituar në thesarin e letërsisë, kulturës dhe të shkencës së letërsisë. Është personalitet poliedrik i studimeve letrare me famë kombëtare dhe ndërkombëtare. Opusi i veprave të tij është i gjerë dhe ka vlerë të madhe, duke u përfshirë kështu në thesarin e trashëgimisë e çmuar të artit letrar, të shkencës së letërsisë, të mendimit shqiptar të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar dhe të fillimit shekullit të ri.

Shquhet posaçërisht me veprimtarinë universitare, me krijimtarinë letrare (autor i romaneve dhe dramave), si studiues i mirëfilltë i shkencave filologjike, është historian i letërsisë, kritik letrar, publicist etj. Ka botuar shumë vëllime të Ditarit. Bibliografia e punimeve dhe veprave të botuara është jashtëzakonisht e pasur. Botimi i veprave të plota përfshin 29 vëllime. Veprat e zgjedhura të Qosjes janë botuar në disa gjuhë të huaja.

Akademik Rexhep Qosjes për veprimtarinë e gjithanshme shumëvjeçare, i janë dhënë shumë mirënjohje dhe dekorata. Është dekoruar me Urdhrin Nderi i Kombit. Rexhep Qosja ka hartuar dhe publikuar disa antologji të letërsisë shqipe, siç janë: "Antologjia e lirikës shqipe", "Rilindja", 1970 (Tirazhi 2000 copë) "Antologjia e lirikës shqipe", botim i dytë i plotësuar dhe i përmirësuar, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1979, "Antologjia historike e letërsisë shqipe I, Poezia dhe Proza" (Doracak për nxënës të arsimit të mesëm të orientuar), Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1986, "Antologji historike e kritikës letrare (Dorëshkrim)".

Pas botimit të veprave të para: "Episode letrare", Prishtinë 1967, "Dialogë me shkrimtarët", Prishtinë 1968, dhe "Kritika letrare", Prishtinë 1969, Qosja botoi "Antologjinë e lirikës shqipe". Kjo është antologjia e parë gjithëpërfshirëse e lirikës shqipe, e hartuar pas studimit të gjithanshëm të krijimtarisë poetike të shkrimtarëve shqiptarë që nga fillimet e letërsisë së vjetër shqipe deri te ajo letërsia bashkëkohore. Me lirikën e zgjedhura, që nga Jeronim de Rada e këndeje, deri te Ali Podrimja, pra deri në vitin 1970 përfshihen 31 poetë, prej 1 deri 31 poezi. Më shumë poezi në antologji ka Asdreni, ndërsa një poezi Musa Vyshka.

Në parathënien e antologjisë (35 faqe tekst) përmbledhen rezultatet e deriatëhershme të studimit të lirikës dhe përgjithësisht të letërsisë shqipe, metodologjia e hartimit të antologjisë dhe shqiptohet vlerësimi



Akademik Rexhep Qosja është krijues letrar dhe studiues i jashtëzakonshëm i historisë së letërsisë shqipe. Vepra e tij letrare dhe shkencore ka zënë vend të merituar në thesarin e letërsisë, kulturës dhe të shkencës së letërsisë

artistik, stilistik dhe gjuhësor, i shprehjes së figurshme të lirikës shqipe. Autori jep shpjegimin për aspekte të poezisë së vjetër shqipe dhe të poezisë së re të epokës së Rilindjes shqiptare. Ai shkruan se "me termat e vjetër dhe e re nuk duhet të nënkuptojmë edhe vlerësimin apo diferencimin kualitativ, artistik të poezisë së krijuar para Rilindjes Kombëtare prej asaj që krijohet gjatë dhe pas saj".

Qosja vlerëson se "me poezi të re shqipe, për herë të parë shënohet dukshëm inkudrimin ynë në kulturën evropiane dhe, ndonëse me një vonesë të përligjur historikisht, prej kësaj kohe në letërsinë tonë do të shfaqen, kur më qartë e kur më zbetë, përpjekjet, idetë dhe rymat kryesore të letërsive të popujve të mëdhenj evropianë". Në studimin që e shquan erudicioni jashtëzakonshëm dhe përvoja e spikatur vlerësues e letërsisë shqipe, që do të dëshmohej sidomos me studimet historike letrare dhe të botimit të "Historisë së letërsisë shqipe" në tri vëllime, analizon dhe vlerëson lirikën shqipe të gjithë autorëve të zgjedhur, të merituar, sipas, tij, për t'u përfshirë në "Antologjinë e lirikës shqipe". Ai ka dhënë shënime se cilat kanë qenë kriteret e përpilimit të antologjisë. Ai shkruan se "përpiluesi i antologjisë nuk është qëmtues i një numri çfarëdo qoftë vjen prej fondit të poezisë kombëtare, por zgjedhës i vjershëve më të bukura të këtij fondi.

Në botimin e parë Qosja zgjedh poezitë e këtyre poetëve: Jeronim de Rada, Gavril Dara i Riu, Zë Seromë, Nami Frashërti, Zë Smiroi, Anon Zakon-Çajupi, Nder Mjeda, Aleks Stavre Drenova, Fan Noli, Ali Asllani, Lasgush Poradeci, Millosh Gjergj Nikolla, Petro Marko, Andrea Varfi, Dhimitër S. Shuteriqi, Esad Mekuli, Mark Gurakuqi, Lllazar Siliqi, Enver Gjerqeku, Vehbi Skënderi, Fatos Arapi, Dritëro Agolli, Dhori Qirjazi, Din Mehmeti, Muhamed Kërveshi, Ismail Kadare, Fahredin Gunga, Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, Musa Vyshka dhe Ali Podrimja.

Botimi i dytë i plotësuar dhe i përmirësua i Antologjisë së lirikës shqipe (1979) ka disa ndryshime sa

i përket përfaqësimit të disa autorëve dhe të poezive të zgjedhura. Janë hequr autorët: Gavril Dara i Riu, Lllazar Siliqi, Musa Vyshka dhe Ali Podrimja. Janë shtuar poetët të cilët nuk ishin përfshirë në botimin e parë, siç janë: Adem Gajtani, Qerim Ujkani, Beqir Musliu dhe Miokom Zeqo. Po ashtu, disa herë është zvogëluar apo është shtuar numri i poezive të zgjedhura. Lexuesit dhe studiuesit sigurisht kanë vlerësimit e tyre, jo vetëm për zgjedhjen e autorëve dhe të lirikave të bukura. Lidhur me kriteret e zgjedhjes së poezive, Qosja ka paraqitur disa kriteret e tij të qëndrueshme. Ai ka shkruar në vijim: "...jam përpjekur ta përpiloj këtë antologji prej vjershash që përmbajnë një përjetim sa më të thellë, më të fuqishëm – që ishte kriteri i parë; që këtë përjetim ta kenë sa është e mundur më të rëndësishëm – që ishte kriteri i dytë; që këtë përjetim ta realizoj brenda një strukture sa më të pasur poetike – që ishte kriteri i tretë; dhe që këtë përjetim ta kenë të shprehur teknikisht në një mënyrë sa më të përsosur – që ishte kriteri i katërt, ndonëse jo edhe i fundit."

"Antologjia historike e letërsisë shqipe I, Poezia dhe Proza" (Doracak për nxënës të arsimit të mesëm të orientuar) është libër për nxënësit e arsimit të mesëm. Në Parafjalën e këtij vëllimi autori shkruan: "Mbështetja në kriterin e parë, historiko-letrar, kushtëzon kujdesin e domosdoshëm për vazhdimësinë e letërsisë shqipe prej fillimit të shkrimit të saj e deri në ditët tona...Mbështetja në kriterin e dytë, artistiko letrar, kushtëzon kujdesin për cilësinë artistike të shkrimeve... dhe t'u takojnë atyre periudhave letrare kur botohen...Është e qartë se vlera letrare artistike a letrare shkencore e shkrimeve të këtyra vetvetiu, është edhe vlerë e tyre historiko-letrare". Libri ka dy pjesë: Pjesa e parë POEZIA dhe Pjesa e dytë PROZA. Në ballë të Pasqyrës së lëndës kanë zënë vend dëshmitë e para të shqipes së shkruar. Në Pjesën e parë zgjedhën krijimet letrare të Poezisë së vjetër (5 autorë), të bejtexhinjve (4 autorë), të Romantizmit (9 shkrimtarë), të periudhës prej romantizmit deri te realizmi

(7 poetë), Poezia sociale (6 shkrimtarë) dhe Poezia e sotme (18 autorë). Në kuadër të pjesës së dytë PROZA përfshihet Proza e vjetër (8 autorë), Romantizmi (3 autorë), Prej romantizmit deri te realizmi (3 autorë), Proza sociale (9 përfaqësues), Proza e sotme (12 prozatorë). Për të gjithë autorët e zgjedhur dhe për shkrimet e tyre janë dhënë shënime të duhura shumë interesante për lexuesit dhe studiuesit e letërsisë.

"Antologji historike e kritikës letrare" (Dorëshkrim) nuk është e njohur nga studiuesit e kritikës letrare. Si dorëshkrim është dorëzuar për botim në Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Si anëtar i jashtëm i Pleqësisë Programore të këtij botuesi e kam lexuar dhe vlerësuar edhe këtë dorëshkrimin. Meqë antologjia nuk është botuar, japim këtë vlerësim shkencor të atëhershëm. Vepra "Antologjia historike e kritikës letrare", e përgatitur për botim nga akademik Rexhep Qosja, përfshin lëndë interesante, të zgjedhur nga gjithë kritikë letrare e traditës dhe nga ajo bashkëkohore. Në këtë antologji janë paraqitur rrjedhat e zhvillimit të kritikës letrare në kuptimin e gjerë të fjalës, me shtrirje në të gjitha periudhat dhe etapat e zhvillimit të letërsisë. Qëndrimi kritik ndaj krijimtarisë letrare dhe ndaj kritikës së saj në tërësi, studimi dhe vlerësimi i gjithanshëm i problemeve, i dukurive të letërsisë dhe të kritikës letrare, si edhe aftësia e përkushtimi i studiuesit të afirmuar, kanë bërë që në këtë antologji mjaft voluminoze në mënyrë kronologjike të përmbledhen: kritika, vështrime, ese, trajtesa dhe studime të zgjedhura për letërsinë

Në "Parafjalën" e këtij vëllimi të antologjisë autori ka dhënë sqarimet e duhura lidhur me çështjet më të rëndësishme të sajimit të "Antologjisë historike të kritikës letrare". Ky tekst i hyrjes ofron njohuri, pikëpamje dhe vlerësime të sintetizuara lidhur me problematikën mjaft komplekse të antologjisë së këtij lloji. Në vazhdim janë dhënë edhe kriteret, në bazë të të cilave janë përfshirë autorët më të

njohur të kritikës dhe të mendimit estetik shqiptar. Me përkushtim të posaçëm janë hetuar prirjet dhe veçoritë karakteristike, por edhe ato të përgjithshme, të mendimit kritik letrar të brezave të ndryshëm.

Antologjia hapet me një tekst të zgjedhur të humanistit shqiptar, Marin Barletit, "Shkrimtari dhe historia" dhe mbyllet me vështrimin e Bajram Krasniqit "Kritika dhe vetëdija historike". Janë përfaqësuar gjithsej 27 autorë, me 56 tekste të kritikës letrare. Zakonisht çdo autor është prezantuar me një, dy ose tri njësi të kritikës letrare në kuptimin e gjerë të fjalës. Këta autorë janë: Marin Barleti, Frano Bardhi, Pjetër Bogdani, Jeronim de Rada, Jani Vreto, Vinçenc Dorsa, Naim Frashëri, Mikel Markiano, Albert Stratigoi, Faik Konica, Luigi Gurakuqi, Fan S. Noli, Nonda Bulka, Mitrush Kuteli, Dhimitër S. Shuteriqi, Vehap Shita, Kudret Velça, Hasan Mekuli, Gjergj Zheji, Razi Brahim, Ali Aliu, Mensur Raifi, Jorgo Bullo, Italo Konstantin Fortino, Agim Vinca, Sabri Hamiti dhe Bajram Krasniqi.

Jemi të bindur se në këtë antologji duhej të përfshiheshin edhe disa autorë të tjerë. Në këtë mënyrë mendimi kritik letrar dhe estetik do të përfaqësohej në gjerësi më të madhe...Përpiluesi i "Antologjisë historike të kritikës letrare" kritikant, vështrimet, esetë, trajtesat, studimet e zgjedhura etj. i ka marrë nga veprat e veçanta të autorëve të shënuar më lartë, ose nga periodiku në gjuhën shqipe. Është e arsyeshme të shënohen burimet përkatëse të literaturës kritike, sepse në këtë mënyrë lexuesit i ofrohet informacion më i gjerë lidhur me kritikën letrare shqiptare. Antologjia e kritikës letrare, e përgatitur për botim nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, kështu e kompletuar, do të plotësohte kërkesat e lexuesve të shumtë, dhe sidomos ato të nxënësve dhe të studiuesve. Ajo do të zgjonte interesimin e tyre, që me përkushtim edhe më të madh, të përcjellin kritikën letrare dhe studimet historike letrare në përgjithësi.

Antologjitë e letërsisë shqipe të Rexhep Qosjes janë vepra të rëndësishme të studiuesit më të shquar të mbarë letërsisë dhe të kulturës shqiptare.

Nderim dhe përkujtim i përjetshëm për Akademik Rexhep Qosjen! Në Graz (Austri) më pikëlloj thellë lajmi se sot (23 prill 2026) ndërroi jetë shoku ynë i Shkollës Normale të Prishtinës (1954-1959), Rexhep Qosja. Që atëherë, deri më sot, 72 vjet kemi kaluar së bashku, në studime dhe në veprimtari arsimore, kulturore dhe shkencore. Ai është krijues letrar dhe studiues i jashtëzakonshëm i historisë së letërsisë shqipe. Lavdi jetës dhe veprës së Akademik Rexhep Qosjes!

Në 88-vjetorin e lindjes së akademik Rexhep Qosjes Seminari XVIII Ndërkombëtar i Albanologjisë i Universitetit të Tetovës, me përkushtim të veçantë studimor në programin e vitit 2024 kishte përfshirë temën "Kontributi i Rexhep Qosjes për letërsinë dhe kulturën shqiptare". Duke vlerësuar lart studimet për jetën dhe krijimtarinë letrare dhe shkencore, kam përgatitur kumtesën kushtuar botimit të antologjive të letërsisë shqipe të Rexhep Qosjes. Kumtesa botohet në version të shkurtuar nga Redaksia.

© KOHA Ditore

IN MEMORIAM: REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

Vdekja më vjen prej syve të tillë

Si u botua romani në Tiranë. Çështje të kujtesës. Një bashkëpunim me Kadarenë

Zija Çela

Me kalimin e kohës askush nuk është i mbrojtur nga harrësia, e cila shkakton humbje të kujtesës. E prirur për të humbur është sidomos fjala e folur. Prandaj dëgjohet shpesh se e folura fluturon, ndërsa fjala e shkruar mbetet.

Jo rastësisht m'u ndërmed kjo temë. Ndoshta secili, në mënyrën e tij, ballafaqohet përgjatë jetës me ronitjen e fshehtë dhe të pandalshme të kujtesës. Kohët e fundit, u ndodha edhe unë para një befasi, që thauja se kishte dalë nga mendja. Natyrisht, rrëfimet e kësaj natyre nuk përbëjnë vetë Historinë e Letërsisë. Por ato dëshmojnë si është jetuar historia, etapet dhe përditshmëria e saj, për çka publiku ka gjithnjë interes. Më poshtë po rrëfej një episod të tillë. Është një rast domethënës me një personalitet të njohur gjerësisht. Por, në fillim, ja si e kujton vetë Rexhep Qosja. Dha ai e kujton me shkrim, prandaj mund të citohet fjalë për fjalë:

"18.8.1987

Gazeta politiko-shoqërore dhe kulturore e Tiranës 'Drita', botoi një vështrim të gjatë, në tri faqe të saj, për romanin tim 'Vdekja më vjen prej syve të tillë', të shkruar prej prozatorit, pa dyshim shumë të talentuar, Zija Çela. Nuk e njoh autorin e këtij vështrimi, nuk jam parë ndonjëherë me të sado kam qenë shumë herë në Shqipëri para vitit 1981. Vështrimi është shkruar me përkushtim, me dashuri, me kulturë dhe me dhunti kritikoletrare. Vështrimi e nxiti shumë kureshtjen e lexuesit për ta lexuar romanin – ashtu dinë të shkruajnë vetëm kritikët e rrallë. Zija Çela e ngre krijimtarinë time dhe etikën intelektuale. Prej vështrimit shihet se Zija Çela e ka lexuar edhe 'Morfologjinë e një fushate'. Nuk e di kur dhe se si mund t'ia kthej prozatorit të talentuar Zija Çela këtë përkushtim vëllazëror. Vështrimi i tij dëshmon se veprat e mia kritike, teorike, historiko-letrare, publicistike dhe letrare po bëhen gjithëkombëtare dhe po bëhen kështu gjithëkombëtare se kanë filluar të lexohen dhe, sigurt, do të lexohen gjithnjë e më shumë edhe prej lexuesve në Shqipërinë shtetërore. Nuk jam krijues i vetëkënaqur, jo, në asnjë rast, jam krijues i vetëdijshëm për të metat e krijimtarisë sime por, megjithatë, mund të them se e gjithë vlera dhe rëndësia e veprës sime do të njihen plotësisht dhe do të çmohen drejt, aq sa e meritojnë, vetëm mbasi të njihet edhe ky Ditar, natyrisht, në qoftë se e do fati dhe

ruhet e mbërrin një ditë në duart e lexuesve. Por kjo do të ndodhë vonë, ndoshta vetëm pas vdekjes sime."

Fati deshi më të mirën, ditari "Dëshmitar në kohë historike" mbërriti në duart e lexuesit në të gjallë të autorit. Ai është botuar në VIII vëllime nga "Toena". Ndërsa citimi i mësipërm i përket Ditar VI, faqe 374. Ky episod ma rigjallëroi kujtesën, duke më dhënë shkak të rrëfej sesi u arrit të botohej në Tiranë romani "Vdekja më vjen prej syve të tillë".

Asokohe unë punoja në gazetën "Drita". Vjen një ditë në redaksi Ismail Kadare, i cili e kishte lexuar romanin e Qosjes, botuar në Prishtinë nga "Rilindja", më 1974. Kishte ardhur me dëshirën e mirë që libri të botohej edhe në Tiranë. Po i ndajmë punët, më tha intimisht, unë po bëj një recension pozitiv për "Naim Frashërin", ti pastaj kërkto të jesh redaktor i romanit. Siç thamë, ashtu bëmë.

Merret me mend se midis Tiranës dhe Prishtinës së atëhershme kishte dallime të hatashme në fushën e botimeve, atje publikoheshin tërë autorët përendimorë që këtej anatomo heshin si "dekadentë". Akademik Rexhep Qosja, i shquar në fushën e Letrave, përveç të tjerave ishte tepër kurajoz në mbrojtje të interesave të Kosovës dhe çështjes kombëtare. Intervistat që i jepte shtypit të huaj dhe që krijonin jehonë ndërkombëtare, i botonim herë pas here në "Drita".

Autori e kishte cilësuar gjininë letrare të atij libri nëpërmjet një propozimi hipotetik: "Trembëdhjetë tregime që mund të bënin një roman". Pa hyrë ende në përmbajtje, që këtu fillonte ballafaqimi me kritikën tonë letrare skematike. Ama, tepër skematike e agresive, e ideologjizuar deri në mbingopje dhe në mbytyje të lirisë së artit. (E si qenka e mundur, ku e thotë estetika marksiste-leniniste dhe metoda e realizmit socialist se trembëdhjetë tregime mund të bëjnë një roman?! Një vër në ujë mund të bëjnë!..) Romani i Qosjes, duke dhënë tablonë e asaj kohe në një qytet konvencional, gjithë tashun e drejton te Danjollit i Sherkes, shërbëtori i pushtuesve të huaj, sytë e të cilit e përgjontin deri në atë shkallë, sa Xhezairit të Xhikës (protagonistit) prej tyre mund t'i vinte vdekja. E desha këtë veprë që në leximin e parë dhe ia viente përballja me kritikën zyrtare.

Si redaktor tashmë nuk kujtoj hollësisht, por përjashtim të pak rreshtave që m'u desh t'i hiqja. Një plumb depërton nga dritarja në studion e protagonistit, i bie fotos së Mao Ce Dunit në mur dhe e rrëzon përtokë.

Mbasi hoqa këto rreshta, shpresova se e "shpëtova" krejt veprën, të cilën e dorëzoja në "Naim Frashëri". Kështu, me gjasë, të dy nisiatorët e fjetëm mendjen.


Mirëpo prit e prit, botimi kërkund! Takohemi përsëri. Ismaili kishte mësuar (atij nuk i shpëtonin pa i marrë vesh "pëshpëshet" e kryeqytetit) se, pasi e kishte lexuar, nëndrejtori i shtëpisë botuese e kishte futur dorëshkrimin në sirtar, duke qenë kundër. Mua më mbetej të trokisja menjëherë tek ai si redaktor i librit. Çfarë leximi të mbrapshtë i kishte bërë! Masakra niste nga fillimi e deri në fund. (Për shembull, duhej hequr krejtësisht "Trashja", tregimi kapitull me të cilin niste libri.) Por kundërsh-timi kryesor rrokte krejt veprën. Sipas nëndrejtorit, romani nuk mund të botohej se ishte kundër (!) inteligjencies kosovare.

E pashë se me argumente nuk hante pykë dhe, siç e shestuam me Ismailin, duhej të provonim ndonjë ndërhyrje diku lart. Por kujt t'i drejtohem?

Këtë ndërhyrje e bëra te Mehmet Karakushi, i cili mbulonte kulturën në Komitetin Qendror. Karakushi ishte nga një fshat diku afër Qafës së Prushit, në kufi me Kosovën. Ne ishim dëgjuar gjatë viteve që kisha punuar si mësues në Has, madje njerëzit e së shoqes (Pogajt) i kisha njohur nga afër në Krumë. Dhe ky burrë i njerëzishëm, pavarësisht nga posti partiak dhe linja politike që mbronte, në mirëdashje dhe në mirëbesim ia hapi rrugën botimit me një telefonatë. Po si, si do të botohej libri, i dhunuar dhe i përcudnuar? Jo, përkundrazi, pa u prekur versioni i plotë që kisha paraqitur në redaksi.

Pastaj gjërat i çuam deri në fund. Unë bëra shkrimin në "Drita". Dhe në dosjet e mia e gjeta këto ditë (2018 vj.). Mban titullin "Në emër të dashurisë ndaj njeriut, të vendlindjes dhe të së bukurës". Është botuar më 26 korrik 1987, në faqet 6, 7 e 10 të gazetës. Për hir të së vërtetës, në atë kohë nuk e kisha lexuar "Morfologjinë e një fushate". Atëherë dhe sot, unë e pëlqej debatin e ideve mes kolegëve, por në kufirin që përjashton mëritë, gjendet inatçore dhe fyerjet ndaj një-tjetrit. Megjithatë, për ta mbrojtur botimin e romanit në Tiranë, ndër të tjera, i dilja para atyre kritikave që kishte "depozituar" zyrtari i shtëpisë botuese dhe që mund të gjenin mbështetjen e militantëve të kalemit.

Sidoqoftë, "fundi i lumtur" nuk mbaron me kaq. Ismaili e çoi përpara "synimin strategjik", atë njerëzorin si kolegu për kolegun, por sidomos



Mirëpo prit e prit, botimi kërkund! Takohemi përsëri. Ismaili kishte mësuar (atij nuk i shpëtonin pa i marrë vesh "pëshpëshet" e kryeqytetit) se, pasi e kishte lexuar, nëndrejtori i shtëpisë botuese e kishte futur dorëshkrimin në sirtar, duke qenë kundër

pikësynimin atdhetar. Ai e rekomandoi në Francë dhe romani u botua atje. Kritika franceze e mirëpriti dhe pati mjaft shkrime. Merret me mend, duke folur për autorin nga Prishtina, doemos përmendje Kosova. Në atë kohë, Prof. Remzi Pernaska bëri një përmbledhje nga shtypi francez, duke i sjellë citimet e vlerësimeve bashkë me emrat që kishin nënshkruar. Ne i dhamë vend menjëherë në gazetë. Më kujtohet se profesori, s'di përse, në atë faqe alla-franceze kishte përfshirë edhe një vlerësim nga shkrimi im.

Mbas dymijëshit i kam bërë një vizitë në shtëpi Rexhep Qosjes. Me kafën përpara, kemi shkëmbyer mendime, jemi pajtuar dhe, për çështje të caktuara, kemi pasur opinione të kundërta. Por mbaj mend se i zoti i shtëpisë më ka dhuruar libra, pastaj më ka përcjellë deri te dera e oborrit, ku jemi ndarë miqësisht.

Nuk jam i sigurt sa vite kaluan pastaj, kur u "takuam" përsëri në panairin e librit në Shkup. Botuesja jonë, zonja Irena Toçi, kishte vënë në stendën e "Toenës" dy posterat tanë. Si të mos mjaftonin emrat, ajo ishte kujdesur që secilit t'i shkruhej edhe "Nderi i Kombit". Kishim ndjekur çdonjëri rrugën e vet dhe, së fundmi, ja një pikë ku bashkoheshin shtigjet. Ishim ballë për ballë, në atë mënyrë

që shiheshim sy më sy dhe më dukej sikur po i flisnim njëri-tjetrit. Atëherë nuk e dija, por tash më lejohet të përfytyroj sikur Rexhep Qosja diç më murmuriste për pengun e tij të vjetër: "Nuk e di, Zija Çela, kur dhe si mund të ta kthej atë përkushtimin tënd vëllazëror." Ndërsa unë, për ta qetësuar, pëshpërisja gjithashtu: "Të falënderoj për mirënjohjen, Rexhep i dashun, veçse rri pa merak. Mua më është dashur të shprehem me vakt, madje ta përsëris herë-herë: Kur kam mundësi të bëj një të mirë, nuk e kryej me shpresën që të më kthehet, por me bindjen që të bëhem vetë më i mirë."

Kështu pra, me kalimin e kohës kujtesa pëson humbje, madje rrezikon të shpërbëhet dalëngadalë. Ditarët dhe memoristika në përgjithësi e regjistron. Ne që e jetuam gjatë një pjesë të historisë së letërsisë, ia vlen të dëshmohe mi me shkrim. E shkruara mbetet. Dhe mbetet sidomos kur objektiviteti nuk i vijnë tronditje prej syve të njëri-tjetrit.

Ky shkrim është botuar për herë të parë në Koha.net në prill të vitit 2018. Botohet në nderim të akademik Rexhep Qosjes.

© KOHA Ditore

MBT: IN MEMORIAM: REXHEP QOSJA (25 QERSHOR 1936 – 23 PRILL 2026)

"Një zbulim i vërtetë, ky shkrimtar është i madh"

"Qosja arrin që të trajtojë çështje thelbësore të jetës dhe në këtë mënyrë artin e vet dhe njëkohësisht artin e popullit të vet ta ngrejë vërtet në nivelin e lartë botëror"

Robert Elsie: Rexhep Qosja është një nga kritikët më të shquar e më prodhimtarë të Ballkanit.

Frédéric Vitoux: Një zbulim i vërtetë, ky shkrimtar është i madh... Si ta cilësojmë këtë roman ("Vdekja më vjen prej syve të tillë")? Është e pamundur të cilësohet, i shpëton çdo cilësimi ose, që është e njëjta gjë, është i shumëfishtë... Tregimi i mrekullueshëm, gjithandë, fantazi filozofike, kronikë përmalluese e një qyteti të vogël të Kosovës.

Tode Çolak: Qosja arrin që të trajtojë çështje thelbësore të jetës dhe në

këtë mënyrë artin e vet dhe njëkohësisht artin e popullit të vet ta ngritë vërtet në nivelin e lartë botëror.

Ibrahim Rugova: [Rexhep Qosja] shpesh ka zgjidhur probleme vitale në letërsi.

Ismail Kadare: Rexhep Qosja është shkrimtari më i madh ndër shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve të vendit, të cilët përbëjnë më shumë se gjysmën e kombit shqiptar.

Ali Aliu: (Proza e Qosjes bën) trajtimin më të thellë dhe më kompleks deri më sot në prozën tonë.

Agim Vinca: Akademik Rexhep

Qosja është pa dyshim një nga figurat më të mëdha të letërsisë e kulturës shqiptare, por edhe një nga personalitetet më me ndikim në jetën shoqërore e politike jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri.

Sabri Hamiti: Rexhep Qosja në fund të viteve gjashtëdhjetë përmbyste "Dasmën" e Kadaresë si dhe metodën e socrealizmit.

Vlerësime ndër vite për akademik Rexhep Qosjen

© KOHA Ditore



Rexhep Qosja, portret Piro Stefa, akuarel 1999